

# Ndërmjetësimi në Kosovë

## VËSHTRIM DHE REKOMANDIME



Alternative Dispute Resolution Center  
Mediation Center Mitrovica

## Ndërmjetësimi në Kosovë: Vështrim dhe Rekomandime

### Publikuar nga

Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADRC) përmes projektit *"Drejt fuqizimit të ndërmjetësimit në Kosovë: një qasje e re"*

### Rreth publikuesit

Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADRC) është organizatë multietnike me qendër në Mitrovicë, puna e së cilës është e përqendruar në ndërtimin dhe promovimin e një kulture të mirëkuptimit të ndërsjellë, angazhimit paqësor dhe kohezionit shoqëror ndërmjet komuniteteve. ADRC përpiqet që të ofrojë një platformë për angazhim ndëretnik dhe të kontribuojë në zhvillimin e komuniteteve.

Organizata gjithashtu punon për të mbështetur fuqizimin e sistemit të drejtësisë në veçanti në rajonin e Mitrovicës. Ka arritur të asistojë qasjen në drejtësi dhe punën e Gjykatës Themelore dhe Prokurorisë Themelore në Mitrovicë në mënyrë eksponenciale përmes ofrimit të shërbimeve të shpejta, efikase dhe me kosto të ulët të ndërmjetësimit dhe është e fokusuar që të vazhdojë të mbështesë punën e strukturave të drejtësisë në rajon (të Mitrovicës).

Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve – Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë

Adresa: "Oliver Ivanović/Sami Frashëri", Nr. 52 Mitrovicë, Kosovë

Kontakti: [info@mediation-mitrovica.org](mailto:info@mediation-mitrovica.org) | +383 (0) 45 309 715 +383 (0) 49 403 203

Ueb-site: [www.mediation-mitrovica.org](http://www.mediation-mitrovica.org)

Ky publikim është realizuar me mbështetjen e UNMIK-ut. Përmbajtja dhe mendimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e Qendrës për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADRC-së) dhe në asnjë mënyrë nuk reflektojnë pikëpamjet e donatorit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në ndonjë formë dhe mënyrë pa leje.



## PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b> .....	1
<b>METODOLOGJIA</b> .....	2
<b>ZHVILLIMI NDËRKOMBËTAR I NDËRMJETËSIMIT DHE HISTORIA E TIJ</b> .....	3
<b>HISTORIKU I NDËRMJETËSIMIT NË KOSOVË</b> .....	4
<b>NDËRMJETËSIMI BASHKËKOHOR NË KOSOVË</b> .....	6
Ndërmjetësimi bashkëkohor në Kosovë: Faza I.....	7
Ndërmjetësimi bashkëkohor në Kosovë: Faza II.....	8
Ndërmjetësimi "në ligj".....	9
Ndërmjetësimi "në praktikë".....	16
Përmbledhje e Statistikave të Ndërmjetësimit: 2008 - 2018.....	23
Ndërmjetësimi bashkëkohor në Kosovë: Faza III.....	23
Ndërmjetësimi "në ligj".....	24
Ndërmjetësimi "në praktikë".....	32
Përmbledhje e Statistikave të Ndërmjetësimit: 2019.....	39
<b>QENDRA PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË KONTESTEVE - QENDRA PËR NDËRMJETËSIM MITROVICË</b> .....	39
<b>REKOMANDIMET</b> .....	41

## HYRJE

Rrënjët e termit "*ndërmjetësim*" mund të gjurmohen në gjuhën greke dhe ndërhyrjet e *mesitis* dhe *mesitaes* në mosmarrëveshje.<sup>1</sup> Folësit e gjuhës latine gjithashtu do të njohin termat *mediare* ose *medius*, që do të thotë "*qëndrim në mes*".<sup>2</sup> Gjatë kohës, këto terma evoluojnë në praktikën formale të ndërmjetësimin në të cilën një palë e tretë (ndërmjetësuesi/ja), u asiston dy apo më shumë palëve, me pëlqimin e tyre, që të parandalojnë, menaxhojnë ose zgjidhin një kontest/konflikt duke i ndihmuar ata/o të arrijnë marrëveshje reciprocisht të pranueshme.<sup>3</sup>

Ndërmjetësimi bashkëkohor sot është pjesë e familjes së Mekanizmave Alternativë të Zgjidhjes së Kontesteve (ADR). ADR i referohet çdo mjeti apo mënyre për zgjidhjen e kontesteve apo konflikteve që aplikohet jashtë sallës së gjykatës dhe përfshin Arbitrazhin, Pajtimin, Vlerësimin e Hershëm Neutral, Ndërmjetësimin dhe Negocimin.<sup>4</sup>

Ndërmjetësimi është njëkohësisht praktikë shoqërore (që aplikohet në nivele ndërpersonale dhe në komunitet për të zgjidhur kontestet dhe konfliktet në mes të kolegëve, komuniteteve, pjesëtarëve të familjes dhe miqve), politike (që aplikohet për të lehtësuar dhe ndërmjetësuar marrëdhëniet dhe mosmarrëveshjet e nivelit të lartë ndërmjet akterëve të rëndësishëm dhe/apo ose shteteve), juridike (që aplikohet në kuadër të kornizave ligjore dhe institucionale si alternativë ndaj procedurës gjyqësore).

Ky vështrim fokusohet në kategorinë e fundit. Më 18 shtator 2008, Kosova miratoi Ligjin e saj të parë të Ndërmjetësimin (Nr. 03/L-057), që vendosi një kornizë të ndërmjetësimin për zgjidhjen e kontesteve dhe çështjeve juridike jashtë sallës së gjykatës dhe për rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë. Më 23 korrik 2018, u miratua një Ligj i ri (Nr. 06/L-009) i Ndërmjetësimin, i cili është aktualisht në fuqi.

Ky vështrim i konsideron të dy ligjet e referuara dhe implementimin e tyre praktik, me qëllim të ofrimit të rekomandimeve potencialisht legjislative dhe jo-legjislative që mund të përmirësojnë kornizën aktuale ligjore të ndërmjetësimin dhe forcojnë procedurën ekzistuese. Zhvillimi i ndërmjetësimin në arenën ndërkombëtare dhe në Kosovë, statistikat e ndërmjetësimin dhe kontributi i Qendrës për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADR) në

---

<sup>1</sup> Ndërmjetësues 'fëmër/grua' dhe 'mashkull/burrë'; B Bahtiri & I Qerimi, 'Ndërmjetësimi si mënyrë e zgjidhjes alternative të kontesteve në Kosovë' (2014) NMZAKK 291, f. 293; Shiko në: [https://www.researchgate.net/publication/306527279\\_Mediation\\_as\\_a\\_Way\\_of\\_Alternative\\_Resolution\\_of\\_Disputes\\_in\\_Kosovo](https://www.researchgate.net/publication/306527279_Mediation_as_a_Way_of_Alternative_Resolution_of_Disputes_in_Kosovo)

<sup>2</sup> Po aty, f. 293

<sup>3</sup> Udhëzime Efektive të OKB-së për Ndërmjetësim, 2012

<sup>4</sup> Instituti për Informacion Juridik, 'Zgjidhja alternative e kontesteve' (law.cornell.edu 2017) <[https://www.law.cornell.edu/wex/alternative\\_dispute\\_resolution](https://www.law.cornell.edu/wex/alternative_dispute_resolution)> qasur më 1 maj 2020

fushën e ndërmjetësimit janë gjithashtu të trajtuara në këtë publikim. Publikimi “Ndërmjetësimi në Kosovë: Vështrim dhe Rekomandime” ka për qëllim të angazhojë lexuesin e përgjithshëm dhe atë të zgjedhur. Do të ngritë njohuritë dhe kuptimin e lexuesit të përgjithshëm për ndërmjetësimin dhe zhvillimin e tij në Kosovë, dhe gjithashtu do t'i ndihmojë palët e interesuara dhe akterët relevantë të identifikojnë të metat dhe problemet ekzistuese në legjislacion dhe implementimin e tij, duke ofruar alternativa dhe rekomandime se si mund të tejkalohen ato.

## METODOLOGJIA

Ky dokument është përgatitur gjatë një periudhe pesë-mujore (janar-maj 2020) në kuadër të projektit “Drejt fuqizimit të ndërmjetësimit në Kosovë: një qasje e re” implementuar nga Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADRC) dhe mbështetur nga UNMIK. Bazohet në përvojën, observimet dhe dy mënyra të hulumtimit të ADRC-së.

### Pjesa e parë e hulumtimit konsistoi në:

- ✚ Shqyrtimin, analizën dhe interpretimin e kornizës (bazë) ligjore të ndërmjetësimit në Kosovë.
- ✚ Konsultimin e publikimeve, studimeve dhe materialeve tjera të fokusuara në ndërmjetësim, të realizuara nga akademik dhe organizata jo-qeveritare (OJQ) të Kosovës.
- ✚ Shikimin e publikimeve ndërkombëtare mbi ndërmjetësimin.

### Pjesa tjetër e hulumtimit u përbë nga:

- ✚ Takime me Ministrinë e Drejtësisë dhe Kryetarin e Odës së Ndërmjetësuesve.
- ✚ Intervista dhe komunikime me ndërmjetësues, akterë të shoqërisë civile,<sup>5</sup> përfaqësues të organizatave dhe agjensioneve ndërkombëtare,<sup>6</sup> përfaqësues të sistemit të drejtësisë,<sup>7</sup> dhe përfaqësues të Komisionit të Ndërmjetësimit në Kosovë (që nuk është më aktiv).
- ✚ Takime të punës, që kishin nga pesë pjesëmarrës secila, të asociuar ngushtë me ndërmjetësimin: përfaqësues të Gjykatës Themelore Mitrovicë, Prokurorisë Themelore Mitrovicë, Gjykatës Themelore Prishtinë dhe Ministrisë së Drejtësisë morën pjesë dhe poashtu tetë ndërmjetësues,<sup>8</sup> avokatë dhe një përfaqësuese e Agjencionit për Ndhimë Juridike Falas.

---

<sup>5</sup> OJQ Partners Kosova - Qendra për Menaxhimin e Konflikteve (PK) and OJQ Qendra për Avokim të Kulturës Demokratike (ACDC)

<sup>6</sup> CSSP Qendra e Berlinit për Ndërmjetësim Integruar (CSSP), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), USAID

<sup>7</sup> Përfaqësues të gjashtë Gjykatave dhe Prokurorive Themelore nga i gjithë vendi dhe gjithashtu Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit/Ekspert i Ndërmjetësimit

<sup>8</sup> Nga e gjithë Kosova/shtatë rajonet kryesore. Një ndërmjetësuese nga komunat më veriore të Kosovës poashtu ishte pjesë e takimeve të punës.

Ky dokument u informua nga kontributet e 41 pjesëmarrësve (20 femra/gra dhe 21 meshkuj/burra) të sfoneve të ndryshme etnike dhe profesionale.

## ZHVILLIMI NDËRKOMBËTAR I NDËRMJETËSIMIT DHE HISTORIA E TIJ

Ndërmjetësimi u iniciua në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si përgjigje ndaj trazirave që derivuan nga ankesat lidhur me diskriminimin në punë dhe ato në bazë të racës, dhe si përgjigje ndaj numrit në rritje të rasteve të lehta penale në mes të të afërmeve dhe fqinjëve.<sup>9</sup>

Forma të ndryshme të negociatave për menaxhimin e sindikatave hapën rrugën për institucionalizimin e ndërmjetësimit si alternativë ndaj gjykatës, ndërsa njohja e këtij mekanizmi si mjet për të shmangur trazirat civile dhe grevat daton në fund të shekullit të 19-të.<sup>10</sup>

Legjislacioni mbi ndërmjetësimin në SHBA filloi të zhvillohet në 1960 kur, sipas Judith Saul, një prokuror/e nga Ohio prezantoi një program që ofronte ndërmjetësim si alternativë ndaj një seance gjyqësore. Kjo u pasua nga krijimi i Qendrave Fqinje të Drejtësisë, Nisma Federale për Asistim në Zbatimin e Ligjit, që vuri në dispozicion fonde federale për iniciativat në lidhje me Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADR), dhe kështu me radhë deri kur në fund të vitit 1990, Kongresi i SHBA-ve miratoi Aktin e Reformës në Drejtësinë Civile, që rekomandoi përdorimin e proceseve dhe mekanizmave të ADR si mjet ndaj lëndëve të grumbulluara dhe të pazgjidhura.<sup>11</sup>

Nga SHBA, lëvizja bashkëkohore e ndërmjetësimit u zgjerua në Europë, Australi, Kanada dhe Zelandën e Re në vitet 1980.

Në Europë, megjithatë, ndërmjetësimi "anashkaloi" aspektin social të zgjidhjes së kontesteve dhe u njoh menjëherë si mjet për të luftuar numrin e lartë të lëndëve të grumbulluara dhe të pazgjidhura dhe për të ulur shpenzimet e procedurës gjyqësore në fillim të viteve 2000.<sup>12</sup> Filloi me inkurajimet e Këshillit të Europës për vendet anëtare për të qartësuar procedurën e ndërmjetësimit brenda sistemeve të tyre ligjore më 2002, deri kur një direktivë detyruese për ndërmjetësimin ndërkuftar hyri në fuqi në qershor të vitit 2008.

<sup>9</sup> J Saul, 'Rrënjët juridike dhe kulturore të ndërmjetësimit në Shtetet e Bashkuara' (Opinio Juris in Comparatione, Nr. 1/2012), Dokumenti Nr. 8; Shiko në:

[https://www.researchgate.net/publication/256030033\\_The\\_Legal\\_and\\_Cultural\\_Roots\\_of\\_Mediation\\_in\\_the\\_United\\_States](https://www.researchgate.net/publication/256030033_The_Legal_and_Cultural_Roots_of_Mediation_in_the_United_States)

<sup>10</sup> M McManus dhe Brianna S, 'Histori e shkurtër e zgjidhjes alternative të kontesteve në Shtetet e Bashkuara' (Cadmus Journal 2011); Shiko në: <https://www.cadmusjournal.org/article/issue-3/brief-history-alternative-dispute-resolution-united-states>

<sup>11</sup> J Saul, 'Rrënjët juridike dhe kulturore të ndërmjetësimit në Shtetet e Bashkuara' (Opinio Juris in Comparatione, Nr. 1/2012), Dokumenti Nr. 8; Shiko në:

[https://www.researchgate.net/publication/256030033\\_The\\_Legal\\_and\\_Cultural\\_Roots\\_of\\_Mediation\\_in\\_the\\_United\\_States](https://www.researchgate.net/publication/256030033_The_Legal_and_Cultural_Roots_of_Mediation_in_the_United_States)

<sup>12</sup> R Rewald, 'Ndërmjetësimi në Europë: metoda më e keqkuptuar e zgjidhjes alternative të kontesteve' (2014); Shiko në: <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=59084c8a-49b8-4b45-9f82-5a69ae7dfe57>

Ashtu siç do shtjellohet me vonë, rregullimi i ndërmjetësimit në Kosovë u mbështet në traditën e re europiane dhe ishte pjesë e një procesi më të gjerë që lidhej me agjendën e Bashkimit Europian. Koincidon gjithashtu me miratimin e direktivës së lartpërmendur "Direktiva 2008/52/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit për disa aspekte të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe komerciale", e cila sipas Dr Felix Staffek<sup>13</sup> ishte një shtysë dhe rregullativë e fortë për zhvillimin e ndërmjetësimit në vendet anëtare të BE-së, në të cilat institucionalizimi i ndërmjetësimit si mekanizëm i zgjidhjes së kontesteve daton vetëm disa dekada më herët.

Dhe ndërsa ndërmjetësimi si procedurë e rregulluar me ligj është relativisht i ri, ADR si parim është po aq i vjetër sa konflikti ndërmjet njerëzve. Prandaj, teoria e ndërmjetësimit është një fushë e pasur akademike, ku autorë të shumtë diskutojnë rolin e ndërmjetësuesit/es, autoritetin e tij/saj, atë që bën një ndërmjetësim të suksesshëm, nëse ndërmjetësimi duhet të gjenerojë normë, të edukojë normë apo të avokojë normë, dhe shumë çështje të tjera që lidhen me të, përfshirë dhe mundësinë e ushtrimit të presionit dhe përdorimit të forcës nga ndërmjetësuesit në ndërmjetësimin ndërkombëtar si formë e diplomacisë parandaluese apo e ndërhyrjes humanitare.

Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për ndërmjetësimin si një alternativë ndaj sallës së gjykatës, secili vend i përcakton parimet relevante në legjislacionin e tyre. Por, paanshmëria, konfidencialiteti, vullnetarizmi dhe barazia janë parimet e tij të përgjithshme. Ligji i parë i Kosovës mbi ndërmjetësimin gjithashtu njeherë urgjencën (e procedurës).

## HISTORIKU I NDËRMJETËSIMIT NË KOSOVË

Kur ndërmjetësimi definohet në aspekt të gjërë si praktikë për të zgjidhur kontestet dhe konfliktet në një shoqëri, shihet të ketë një histori të gjërë dhe të larmishme që shtrihet pothuajse në të gjitha kulturat dhe vendet,<sup>14</sup> përfshirë këtu edhe Kosovën. Këtu është e mundur të identifikohen prototipe të praktikave joformale të zgjidhjes së konflikteve që i ngjajnë ndërmjetësimit dhe që përfshijnë ndërmjetësues/e ose palë të treta të besuara. Edhe pse këto lloje të praktikave nuk qëndrojnë shumë afër me praktikën bashkëkohore të ndërmjetësimit, ato i paraprinë atij në shumë aspekte dhe i'a parashikuan një numër të veçorive.

Pra, është e mundur të identifikohet një traditë dhe kulturë e "ndërmjetësimit" në Kosovë e aplikuar nga të gjitha komunitetet, që ndihmoi në zgjidhjen e konflikteve dhe

<sup>13</sup> F Steffek, Ndërmjetësimi në Bashkimin Europian: Një Prezantim (2012)

<sup>14</sup> Ch. W. Moore, Procesi i Ndërmjetësimit (Edicioni i 4, Jossey-Bass, A Wiley Brand, Shtetet e Bashkuara të Amerikës 2014), f. 61



mosmarrëveshjeve. Në raste të tilla, palët e treta (figura autoritative të komunitetit dhe/apo këshilla të të vjetërve) ftoheshin të ndërhyjnë dhe me përvojën dhe mençurinë e tyre të ndihmojnë palët për të zgjidhur konfliktin/et e tyre. Në Kosovë, zgjidhja paqësore e konflikteve lartësohej për shkak të benefiteve që kishte për vetë palët respektive por dhe poashtu për benefitet më të gjëra për shoqërinë. Kur traditat ligjore apo të së drejtës dhe praktikrat e strukturat relevante ende nuk ishin zhvilluar, mungonin apo ishin të rezistuar nga komuniteti, "ndërmjetësimi" plotësonte këto zbrazëti, rregullonte marrëdhëniet/konfliktet dhe kontribuoi në kohezionin shoqëror. U zhvillua me kalimin e kohës dhe u bë pjesë e së drejtës zakonore.

Për shembull, Kodi i Malësisë (*Kanuni i Lekë Dukagjinit ose Kanuni i Malësisë*) i praktikuar dhe respektuar gjerësisht nga shoqëria shqiptare, i njohu dhe vendosi praktika të zgjidhjes së konflikteve të ngjashme me "ndërmjetësimin", dhe i instaloi ato si pjesë të kulturës juridike shqiptare. Kodi i Malësisë është përmbledhje e parimeve, normave dhe rregullave të transmetuara gojarisht dhe brez pas brezi që qeverisën me shekuj jetën e shqiptarëve.<sup>15</sup> Edhe pse ka pasur Kanune të tjera, *Kanuni i Lekë Dukagjinit* konsiderohet të jetë më i rëndësishmi dhe më i aplikueshmi. Rregullonte marrëdhëniet shoqërore dhe bëri të mundur menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve të rënda (p.sh. atyre që mund të nxitnin gjakmarrjen<sup>16</sup>) dhe konflikteve më pak të rënda, si mosmarrëveshjet dhe kontestet familjare, martesore dhe pronesore.<sup>17</sup> Kur Kanuni u kodifikua<sup>18</sup> ndërmjet viteve 1897 dhe 1899, përfshiu një seksion specifik për zgjidhjen e konflikteve dhe "ndërmjetësimin".<sup>19</sup>

Në Kosovë, "ndërmjetësimi tradicional" përfshinte procesin në të cilën kryesi apo dëmtuesi ose familja e tij (sepse ishin kryesisht burra) u kërkonin pjesëtarëve më të vjetër, më të shquar dhe të urtë të komunitetit që të ndërhyjnë bashkërisht dhe të ndihmojnë në mbylljen e konfliktit ndërmjet palëve, duke bërë të mundur kështu, parandalimin e vazhdimin të konfliktit apo lindjen e ndonjë konflikt të ri.<sup>20</sup> "Ndërmjetësimi" bëhej në ambiente neutrale dhe zgjidhja e konfliktit bazohej mbi *Besën* ("fjalën e dhënë").<sup>21</sup> Besa dhe pjesëmarrja e të vjetërve, të shquarve dhe të urtëve vlerësoheshin si garantim që rezultati ose përfundimi do të respektohej.<sup>22</sup> Karakteristika kryesore që e dallon këtë praktikë të ndërmjetësimit me pasardhësin e tij bashkëkohor është se ndërmjetësuesit kishin një zë të fortë dhe fuqi vendimmarrëse në proces.

<sup>15</sup> R. Muharremi & A. Buçaj, 'Zgjidhja alternative e kontesteve dhe Kanuni' (2016) ZAKK 5, f. 9; Shiko në: [https://issuu.com/amchamkosovo/docs/journal\\_of\\_alternative\\_dispute\\_reso\\_c401a90b08fbd8](https://issuu.com/amchamkosovo/docs/journal_of_alternative_dispute_reso_c401a90b08fbd8)

<sup>16</sup> Vetë-gjyqësi/drejtësi, ku vrasja e personit tjetër ka për qëllim hakmarrjen ndaj një krimi apo shkeljes së nderit personal apo atij të familjes; R. Muharremi & A. Buçaj, 'Zgjidhja alternative e kontesteve dhe Kanuni' (2016) ZAKK 5, f. 10

<sup>17</sup> R. Muharremi & A. Buçaj, 'Zgjidhja alternative e kontesteve dhe Kanuni' (2016) ZAKK 5, f. 11

<sup>18</sup> Vendosur në letër, mbledhura në një vend dhe bërë koherente.

<sup>19</sup> R. Muharremi & A. Buçaj, 'Zgjidhja alternative e kontesteve dhe Kanuni' (2016) ZAKK 5, f. 9

<sup>20</sup> Po aty, f. 12

<sup>21</sup> M. Krasniqi, 'Disa karakteristika të ndërmjetësimit në fushën penale në Republikën e Kosovës' (2019) DKNFPRK 190, f. 191; Shiko në: <https://www3.mruni.eu/ojs/international-comparative-jurisprudence/article/view/5219/4621>

<sup>22</sup> Po aty, f. 191

Kjo përmbledhje vetëm tenton që vendosë ndërmjetësimin bashkëkohor në kontekstin e tij historik dhe kështu nuk do të shtjellojë në mënyrë të gjërë "ndërmjetësimin tradicional" ose fazat e ndryshme të zhvillimit të tij. Është e mjaftueshme të theksohet se ndërmjetësimi ishte një praktikë e veçantë dhe joformale me histori përkatëse, që me kalimin e kohës u strukturua gjithnjë e më shumë në Kosovë dhe më gjerë.

## NDËRMJETËSIMI BASHKËKOHOR NË KOSOVË

Është e mundur të identifikohen tre faza kryesore të zhvillimit të ndërmjetëimit bashkëkohor në Kosovë.

### 2001 – 2008

Kishte përpjekje për të promovuar një formë profesionale të ndërmjetëimit që mund të aplikohet në sektorë të ndryshëm. Në këtë periudhë u ndërmorrën nisma dhe aktivitete legislative për vendosjen e ndërmjetëimit në ligj. Kështu, një Ligj i Ndërmjetëimit u përgatit nga akterët e shoqërisë civile, përfaqësuesit e komunitetit dhe organizatave ndërkombëtare, Ministria së Drejtësisë e Kosovës dhe akterë tjerë institucional. Përpjekjet dhe bashkëpunimi i përbashkët rezultuan me Ligjin e parë të Ndërmjetëimit (Nr. 03/L-057), të cilin Parlamenti i Kosovës e miratoi më 18 shtator 2008.

### 2008 – 2018

Ligji i parë i Kosovës për Ndërmjetësim (Nr. 03/L-057) u miratua,<sup>23</sup> dhe u implementua. U plotësua dhe udhëzua nga akte nënligjore dhe punë për krijimin e kapaciteteve të ndërmjetëimit. U hapën Qendra të Ndërmjetëimit që ofrojnë shërbime të ndërmjetëimit në shtatë rajonet e Kosovës. Shoqëria civile dhe komuniteti e organizatat ndërkombëtare janë eminent në secilin pikë. Mbështetja e pamjaftueshme institucionale, çështjet lidhur me qëndrueshmërinë dhe paqartësitë rreth efektit juridike të ndërmjetëimit privat/jashtë gjykatës janë disa nga sfidat me të cilat ballafaqohet mekanizmi i ndërmjetëimit gjatë kësaj dekade. Ligji i parë qëndroi në fuqi deri më shtator 2018.

### 2018 - tutje

Ministria e Drejtësisë, institucionet relevante dhe akterët e angazhuar me ndërmjetësimin kërkuar të adresojnë zbrazëtiet dhe problemet me legjislacionin e ndërmjetëimit duke e nënshtruar mekanizmin ndaj reformave ligjore. Një proces pune dhe draftimi për rreth tre

---

<sup>23</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008

vite rezultoi me Ligjin e ri të Ndërmjetësimit (Nr. 06/L-009), i cili u miratua më 23 korrik 2018.<sup>24</sup> Ky i fundit përmban një numër të amendamenteve dhe ndryshimeve që kanë për synim të zhvillojnë mekanizmin, të promovojnë qëndrueshmërinë e tij dhe të mundësojnë rritjen e përdorimit të tij.

## Ndërmjetësimi bashkëkohor në Kosovë: Faza I

Pas konfliktit të 1998-1999 në Kosovë, një ndihmë dhe investim i madh ndërkombëtar u dedikua drejt rindërtimit të vendit dhe zhvillimit të saj ekonomik, institucional, dhe shoqëror. Komuniteti ndërkombëtar i sheh akterët e shoqërisë civile si të pozicionuar në mënyrë ideale për këto qëllime, dhe kështu fokusohet edhe në krijimin dhe/ose fuqizimin e organizatave partnere. Komuniteti ndërkombëtar investon në drejtime të shumta dhe të ndryshme, përfshirë dhe në zgjidhjen e konflikteve dhe ndërmjetësimin.

Partners Kosova - Qendra për Menaxhimin e Konflikteve u themelua në vitin 2001 si pjesë e Partners Global (Partners Ndërkombëtar për Ndryshim Demokratik). Puna e saj ishte e përqendruar, *inter alia*, në ngritjen e kapaciteteve të ndërmjetësimit të akterëve të ndryshëm (përfshirë të përfaqësuesve të institucioneve, të partive politike, personelit të gjykatës dhe policisë, shoqërisë civile dhe këshillave për pajtimin e gjakmarrjeve<sup>25</sup>).<sup>26</sup> Në 2005, PK zhvilloi një program trajnimi mbi ndërmjetësimin.<sup>27</sup> Kjo organizatë ofroi kontribut të rëndësishëm, dhe mbase atë më të rëndësishmin për ndërmjetësimin - në vitin 2002, kur inicuan diskutimet për të rregulluar ndërmjetësimin me ligj dhe më pas hartuan një draft-dokumenti për këtë.<sup>28</sup>

Dy vite më vonë, avokimi i Partners Kosova për Ligj për Ndërmjetësimin fitoi mbështetjen e Qendrës Kombëtare për Gjykatat Shtetërore (NCSC) dhe të Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).<sup>29</sup> Në dy vitet e ardhshme, këta akterë ndërvepruan me përfaqësues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë në Kosovë (OSBE) dhe të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për të kompletuar projektligjin për ndërmjetësimin, i cili u hap pastaj për konsultime më të gjera që përfshin Kabinetin e Kryeministrit të Kosovës, Ministritë e Drejtësisë, Ekonomisë dhe Financave, dhe të Punës dhe Mirëqenies Sociale, përfaqësues të sistemit të

---

<sup>24</sup> Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim 2018

<sup>25</sup> Trashëgimi të Kanunit dhe të drejtës zakonore; këshilla që zgjidhnin konflikte në bazë të këtyre të fundit (Kanunit/të drejtës zakonore).

<sup>26</sup> Intervistë me Shukrije Gashi, Drejtoreshë Ekzekutive/Partners Kosova - Qendra për Menaxhimin e Konflikteve

<sup>27</sup> Po aty

<sup>28</sup> Po aty

<sup>29</sup> Po aty

drejtësisë, profesorë të Fakultetit Juridik, Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNDP), CSSP Qendrën e Berlinit për Ndërmjetësim Integruar dhe akterë të tjerë.<sup>30</sup>

Në periudhën në vijim, Ministria e Drejtësisë (duke qenë trupi përgjegjës për legjislacionin në fushën e drejtësisë) merr drejtimin e procesit; UNDP e ndihmon atë për të organizuar draftimin, ndërmarrë në pritje të finalizimit.<sup>31</sup> Akterët e lartpërmendur vazhdojnë angazhimin me projektligjin dhe kontribuojnë me përvojën dhe njohuritë e tyre. Ligji i parë i Ndërmjetësimi (Nr. 03/L-057) i prezantohet Parlamentit të Kosovës që e miraton atë më 18 shtator 2008. Ligji në fjalë është pjesë e një pako të ligjeve dhe votohet pa buxhet që siguron implementimin e tij.<sup>32</sup> Ligji i parë i Kosovës për Ndërmjetësimin hyn në fuqi në nëntor 2008.

Hartimi i Ligjit për Ndërmjetësim dhe miratimi i tij bëhet me qëllim:

- ✚ Për të vendosur ndërmjetësimin në ekzistencë ligjore/juridike dhe për të promovuar zgjidhjen e çështjeve dhe kontesteve jashtë sallës së gjykatës.
- ✚ Për të kontribuar në krijimin e një sistemi modern dhe efikas ligjor dhe të drejtësisë.
- ✚ Për të pëmbushur standardet ndërkombëtare.

## Ndërmjetësimi bashkëkohor në Kosovë: Faza II

Faza e dytë e zhvillimit të ndërmjetësimi bashkëkohor në Kosovë konsiderohet ajo që shtrihet ndërmjet 2008 dhe 2018; fillon me miratimin e Ligjit Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim dhe zgjat deri më 2018, kur prezantohet një ligj i ri. Në këtë dekadë, ndërmjetësimi qeveriset dhe zbatohet në bazë të Ligjit Nr. 03/L-057<sup>33</sup> dhe akteve të tjera relevante, në rend të parë:

- ✚ Kodit të Procedurës Penale (Nr. 04/L-123)<sup>34</sup>
- ✚ Kodit të Drejtësisë për të Mitur (Nr. 03/L-193)<sup>35</sup>
- ✚ Një numër të akteve nënligjore të nxjerra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë<sup>36</sup>

---

<sup>30</sup> Po aty

<sup>31</sup> Intervistë me Virgjinia Dumnica, Eksperte e ndërmjetësimi/Këshilltare për Sundim të Ligjit, UNDP

<sup>32</sup> Intervistë me Bekim Ismaili, Ndërmjetësues/Menaxher i Projektit, CSSP

<sup>33</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008

<sup>34</sup> Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale 2012, Neni 232

<sup>35</sup> Kodi No. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur 2010, Nenet 14-15

<sup>36</sup> B Bahtiri & I Qerimi, 'Ndërmjetësimi si mënyrë e zgjidhjes alternative të kontesteve në Kosovë' (2014) NMZAKK 291, f. 297; Shiko në: [https://www.researchgate.net/publication/306527279\\_Mediation\\_as\\_a\\_Way\\_of\\_Alternative\\_Resolution\\_of\\_Disputes\\_in\\_Kosovo](https://www.researchgate.net/publication/306527279_Mediation_as_a_Way_of_Alternative_Resolution_of_Disputes_in_Kosovo)

Ndërmjetësimi poashtu referohet edhe në ligje të tjera (përfshirë ato të procedurës kontestimore, për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe për marrëdhëniet e detyrimeve) që përmbajnë dispozita që kanë të bëjnë me të si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve.<sup>37</sup>

## Ndërmjetësimi "në ligj"<sup>38</sup>

Ligji Nr. 03/L-057 definon ndërmjetësimin si "veprimtari jashtëgjyqësore, që realizohet nga një person i tretë (ndërmjetësuesi/ja) me qëllim të zgjidhjes me pajtim të mosmarrëveshjeve/kontesteve ndërmjet subjekteve të së drejtës".<sup>39</sup> Nenet 1 dhe 9 përcaktojnë se palë në ndërmjetësim mund të jenë personat fizikë dhe juridikë ndërsa neni 2 sqaron se "mosmarrëveshja/kontesti" lind në mes të subjekteve të së drejtës.

✚ Kapitulli i parë i ligjit thotë se ndërmjetësimi mund të zbatohet në një numër të fushave të së drejtës (në marrëdhëniet kontestuese në raportet juridiko-pasurore të subjekteve të së drejtës, tregtare, familjare, të punës, raporte të tjera civile, administrative dhe penale<sup>40</sup>) dhe në raste kur një ligji i veçantë nuk ka paraparë përgjegjësin ekskluzive të gjykatës ose ndonjë organi tjetër kompetent. Neni 232 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se ndërmjetësimi zbatohet vetëm për rastet/veprat penale që dënohen me gjobë ose me burgim deri në 3 vite; përveç kësaj, në këtë fushë ndërmjetësimi mund të përdoret vetëm pas një vlerësimi të kujdesshëm përmes së cilit definohet se një gjë e tillë është e përshtatshme.

Në vitin 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit lëshoi një udhëzim që përcaktonte qartë se ndërmjetësimi nuk duhet të zbatohet për rastet e dhunës në familje.<sup>41</sup>

Ndërmjetësimi sikur dhe çdo procedure tjetër qeveriset nga disa parime të cilat i njeh dhe kapitulli II i Ligjit (Nr. 03/L-057) për Ndërmjetësim. Kapitulli në fjalë liston pesë parime të rëndësishme dhe të njohura si masa garantuese për një procedurë efikase, të drejtë dhe legjitime të ndërmjetësimit në vend. Ato janë:

✚ Shprehja e vullnetit. Palët vendosin në mënyrë të lirë nëse dëshirojnë që të iniciojnë dhe të angazhojnë ndërmjetësimin; mbi këtë bazë ata/o poashtu zgjedhin

---

<sup>37</sup> Po aty

<sup>38</sup> Ky seksion trajton ligjin e mëparshëm për ndërmjetësimin (që nuk është më aktiv) me qëllim që të theksoj aspektet e tij kryesore, të vendos implementimin e tij praktik në kontekst dhe të vë ligjin aktual/në fuqi (për ndërmjetësimin) në perspektivë krahasuese.

<sup>39</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008, Neni 2

<sup>40</sup> Ndërmjetësimi në mes të viktimës - të akuzuarit.

<sup>41</sup> Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Udhëzimi A.nr. 360/16 (2016)

ndërmjetësuesin/en, zhvillojnë procedurën dhe arrijnë përfundimin.<sup>42</sup> Ndërmjetësuesi/ja gjithashtu ka të drejtë të vendos nëse do të ndërmjetësojë apo jo një kontest ose rast të caktuar, edhe pse ligji nuk e thotë këtë shprehimisht.

- ✚ [Barazia](#). Secila palë ka të drejta dhe detyra të barabarta dhe duhet të ketë trajtim të barabartë nga ndërmjetësuesi/ja.<sup>43</sup>
- ✚ [Paanshmëria](#). Ndërmjetësuesi/ja duhet të jetë i/e paanshëm dhe pavarur nga palë të treta apo ndikimet të tjera kur ndërmjetëson.<sup>44</sup>
- ✚ [Konfidencialiteti dhe kredibiliteti](#). Të gjitha aspektet e procedurës së ndërmjetësimit duhet të mbesin konfidenciale, duke përfshirë të gjitha informacionet që janë gjeneruar apo marrë gjatë procedurës. Deklaratat e palëve mund të përdoren diku tjetër vetëm nëse palët japin pëlqimin e tyre. E njëjta vlen edhe për çdo palë të tretë që merr pjesë në procedurë.<sup>45</sup> Edhe pse "kredibiliteti" citohet si parim, ligjvënësi nuk i'a përcakton kuptimin në kontekst të ndërmjetësimit.
- ✚ [Urgjenca](#). Procedura e ndërmjetësimit është urgjente dhe duhet të përfundojë brenda 90 ditëve nga kur ka filluar.<sup>46</sup>

Parimi 1 e vendos në mënyrë të qartë se ndërmjetësimi fillon vetëm me pranimin apo akordin e palëve në kontest apo rast. Neni 9 thotë se konsensusi (për të filluar dhe për të angazhuar ndërmjetësimin) duhet të arrihet brenda 15 ditëve nga kur njëra nga palët fton homologun e tyre për të marrë pjesë. Nëse palët bien dakord, ata/o dhe ndërmjetësuesi/ja,<sup>47</sup> duhet të nënshkruajnë një dokument ("Marrëveshje për Ndërmjetësim"<sup>48</sup>). Ndërmjetësuesi/ja është përgjegjës/e për t'u siguruar se palët janë të informuara në mënyrë të duhur para fillimit të procedurës dhe kur ajo fillon.<sup>49</sup> Kur palët nënshkruajnë "Marrëveshjen për Ndërmjetësim", kjo nuk do të thotë se ata/o janë të detyruar më pas për të zgjidhur kontestin apo rastin e tyre me anë të ndërmjetësimit, pasi dokumenti vetëm reflekton gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar mbi këtë bazë dhe në këtë drejtim. Pas fillimit të procedurës, palët janë përgjegjëse për të zhvilluar atë dhe detajet e saj,<sup>50</sup> dhe ndërmjetësuesi/ja duhet të ndihmoj me mbarëvajtjen dhe gjërat tjera shoqëruese dhe të ofrojë mbështetje dhe lehtësim sa më të mirë.

---

<sup>42</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008, Nenet 3, 9, 10, 12, 14

<sup>43</sup> Po aty, Nenet 4 dhe 11

<sup>44</sup> Po aty, Nenet 5, 11, 14

<sup>45</sup> Po aty, Nenet 6 dhe 10

<sup>46</sup> Po aty, Nenet 7 dhe 13

<sup>47</sup> Megjithëse ekziston një preferencë që ndërmjetësimi të kryhet nga një ndërmjetësues i/e vetëm, ligji gjithashtu lejon bashkë-ndërmjetësim (pra mund të ketë më shumë se një ndërmjetësues).

<sup>48</sup> 'Marrëveshja për ndërmjetësim' duhet të ketë të dhëna për palët e përfshira në procedurë; përfaqësuesit e tyre ligjorë (nëse ekzistojnë); objektin e mosmarrëveshjes/kontestit; deklaratën që tregon pranimin e parimeve të ndërmjetësimit. Kosto e procedurës, përfshirë tarifa e ndërmjetësuesit/es, gjithashtu duhet të shkruhen.

<sup>49</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008, Nenet 9-10

<sup>50</sup> Po aty, Neni 10

Ligji ofron kornizën, por nuk ka për qëllim të përcaktojë ritmin dhe mbarëvajtjen e procedurës, dhe kjo është plotësisht në përputhje me parimin se ndërmjetësimi duhet të udhëhiqet dhe zhvillohet nga palët dhe vullnetet e tyre të shprehura. Sikur në pikën e fillimit, poashtu dhe rezultati i procedurës së ndërmjetësimit duhet të vendoset në shkrim. Nëse ka rezultat të suksesshëm të ndërmjetësimit dhe një marrëveshje arrihet, atëherë ndërmjetësuesi/ja harton një dokument ("Marrëveshje për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar"), që përmban detaje teknike dhe substanciale mbi rezultatin pozitiv të procedurës së ndërmjetësimit dhe marrëveshjen e arritur. Më pas marrëveshja në fjalë nënshkruhet nga palët dhe ndërmjetësuesi/ja.<sup>51</sup> Nëse nuk arrihet zgjidhje dhe nuk ka marrëveshje, ndërmjetësuesi/ja përpilon një raport ku shpjegon detajet dhe rrethanat e ndërmjetësimit të pasuksesshëm.

Dispozitat e ligjit zbatohen për tre lloje (të njohura) të ndërmjetësimit:

- ✚ [Ndërmjetësimi i lidhur me gjykatën.](#) Formë e ndërmjetësimit ku lëndët e gjykatave mund të referohen në ndërmjetësimin për zgjidhje në çfarëdo pike të procedurës, megjithatë, përpara se të nxirret një verdikt nga ana e gjykatës.
- ✚ [Ndërmjetësimi i lidhur me prokurorinë.](#) Formë e ndërmjetësimit, ku pas pranimit të kallëzimit penal/rastit mund të referohet në ndërmjetësim.
- ✚ [Ndërmjetësimi privat/Ndërmjetësimi jashtë gjykatës.](#) Formë e ndërmjetësimit përmes së cilës palët bien dakord të përdorin ndërmjetësimin në mënyrë private edhe pa ndonjë përfshirje tjetër.

#### Ndërmjetësimi i lidhur me gjykatën.

Inicimi i ndërmjetësimit të lidhur gjykatën rregullohet nga nenet 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim. Në vitin 2012, Këshilli Gjyqësor i Kosovës<sup>52</sup> lëshoi një protokoll që rregullonte këtë formë të ndërmjetësimit dhe referimin e rasteve/lëndëve të gjykatës në procedurë të ndërmjetësimit. Gjyqtarët e kanë autorizimin t'i referojnë çështjet apo lëndët në ndërmjetësim para se mbi këto të fundit të nxirret një verdikt i formës së prerë; gjithashtu pritët që ky proces ("i referimit të lëndëve") të konsultohet me palët përkatëse. Palët vendosin për fillimin dhe zhvillimin e procedurës dhe gjithashtu mbajnë të drejtën e tërheqjes në çdo moment. Në ndërmjetësimin e lidhur me gjykatën, ndërmjetësuesi/ja dhe palët kanë përgjegjësi shtesë mbi ato të përmendura më parë; këto përfshijnë informimin e gjykatës për zhvillimet

---

<sup>51</sup> Po aty, Neni 12

<sup>52</sup> KGJK mbikëqyr administrimin e drejtësisë, përkujdeset për pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor dhe është autoriteti kompetent për të vendosur mbi politikën, stafin, dhe krijimin e kapaciteteve të gjyqësorit dhe poashtu adreson rekomandimet në lidhje me sistemin gjyqësor.

kryesore të procedurës në lëndën përkatëse të gjykatës së referuar në ndërmjetësim.<sup>53</sup> Marrëveshja e arritur në ndërmjetësimin e lidhur me gjykatën fiton titull ekzekutiv pas miratimit të gjykatës.<sup>54</sup>

Ndërmjetësimi i lidhur me gjykatën është një nga format më të rëndësishme të procedurës e prezantuar në pritje që do të kursejë shpenzimet gjyqësore, do të rrisë efikasitetin e gjykatës, do të kontribuojë në procesimin dhe mbylljen më të shpejtë të lëndëve, dhe do të zvogëlojë lëndët e grumbulluara dhe të pazgjidhura të gjykatave.

### Ndërmjetësimi i lidhur me prokurorinë

Ndërmjetësimi i lidhur me prokurorinë ngjan me atë të ndërmjetësimin të lidhur me gjykatën. Bazohet në nenet 9 dhe 14 të Ligjit për Ndërmjetësim dhe nenin 232 të Kodit të Procedurës Penale. Prokurori/ja është autoriteti kompetent që referon kallëzimet penale për vepra penale në ndërmjetësim.

Në përgjithësi, për t'u pranuar si i përshtatshëm për ndërmjetësim, një kallëzim penal i një veprë penale/rast i natyrës penale, duhet të plotësojë dy kritere:

1. Duhet që vepra penale të jetë e dënueshme me gjobë ose me burgim deri në 3 vite.
2. Një numër i faktorëve duhet të merren parasysh përpara se kallëzimi penal/rasti të referohet në ndërmjetësim. Këto përfshijnë llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat ajo është kryer, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij/saj, si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të tij/saj.<sup>55</sup>

Në fushën penale, procedura e ndërmjetësimin kryesisht zbatohet për veprat penale që kanë një shkallë më të ulët të rrezikut shoqëror dhe ndodhin shpesh.<sup>56</sup> Në vitin 2013, Këshilli Prokurorial i Kosovës<sup>57</sup> lëshoi një protokoll që definoj ndërmjetësimin e lidhur me prokurorinë dhe referimin e lëndëve të prokurorisë në ndërmjetësim.<sup>58</sup> Organizimi dhe procedura e ndërmjetësimin të lidhur me prokurorinë i ngjan ndërmjetësimin të lidhur me gjykatën dhe kur prodhon marrëveshje, mundëson hudhjen e kallëzimit penal. Marrëveshja ka efekt juridik pasi prokuroria e aprovon atë.<sup>59</sup>

<sup>53</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008, Neni 10

<sup>54</sup> Po aty, Neni 12

<sup>55</sup> Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale 2012, Neni 232

<sup>56</sup> M Krasniqi, 'Disa karakteristika të ndërmjetësimin në fushën penale në Republikën e Kosovës' (2019) DKNFPRK 190, f. 192; Shiko në: <https://www3.mruni.eu/ojs/international-comparative-jurisprudence/article/view/5219/4621>

<sup>57</sup> KPK është organi më i lartë i ngarkuar me paanshmërinë, pavarësinë dhe profesionalizmin e sistemit prokurorial të Kosovës.

<sup>58</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës, Vendimi/Protokoll Nr. 80/2013 mbi referimin e lëndëve nga Prokuroritë Publike në Qendrat e Ndërmjetësimin 2013

<sup>59</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008, Neni 14; Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale 2012, Neni 232



Rëndësia e ndërmjetësimit të lidhur me prokurorinë dhe e ndërmjetësimit në fushën penale në përgjithësi është se e hudh poshtë kallëzimin penal dhe nevojën për procedura të mëtejshme. Kjo zvogëlon shpenzimet e palëve dhe të institucioneve dhe ndihmon në promovimin e drejtësisë restauruese. Ka përfitime të shumta (për palët), që përfshijnë dhe shmangien nga evidentimi në regjistrat penal.

Në të dy format e ndërmjetësimit, gjykata dhe prokuroria mund të mos e aprovojnë marrëveshjen e ndërmjetësimit nëse vërejnë parregullsi procedurale apo se interesat dhe të drejtat e palëve nuk janë respektuar në mënyrë të duhur ose të balancuar.<sup>60</sup> Kjo u mundëson të dy akterëve të sigurojnë që procesi është i drejtë dhe se ai gjithashtu është në linjë me parimin e barazisë.

#### Ndërmjetësimi privat/Ndërmjetësimi jashtë gjykatës

Ndërmjetësimi privat/jashtë gjykatës gjithashtu aplikohet në një mënyrë të ngjashme, megjithëse nuk ka asocim me gjykatën dhe/apo prokurorinë. Palët i ruajnë të gjitha të drejtat që i garanton ligji, por procedura zhvillohet në mënyrë të pavarur (dmth pa përfshirjen e akterëve të tjerë). Kjo është një nga format e ndërmjetësimit që mbetet pak e paqartë. Kjo kryesisht për shkak se ligjvënësi nuk e definoi qartë efektin juridik dhe përmbarimin e ndërmjetësimit privat/jashtë gjykatës dhe marrëveshjeve që derivojnë nga ajo. I atribuohet gjithashtu edhe faktit se nuk ka ndonjë akt nënligjor që e rregullon administrimin dhe raportimin e tij në mënyrë të plotë, të gjërë dhe të kuptueshme.

Neni 12 i Ligjit për Ndërmjetësim përcakton se marrëveshja e ndërmjetësimit privat/jashtë gjykatës ka fuqinë e një dokumenti përfundimtar dhe të detyrueshëm. Ligji Nr. 03/L-008 për Procedurën Përmbarimore (2008) nuk vendos titull ekzekutiv në ujdite jashtë gjykatës dhe Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (2013) nuk definoi qartë se cilën formë të ndërmjetësimit (të lidhur me gjykatën apo atë private/jashtë gjykatës) ka në fjalë kur i referohet përmbarimit të marrëveshjes së ndërmjetësimit; për më tepër, kur duket se i referohet vetëm ndërmjetësimit privat/jashtë gjykatës, nuk qartëson nëse marrëveshjet e arritura në këtë lloj të ndërmjetësimit kërkojnë ndonjë procedurë gjyqësore (apo tjetër) në mënyrë që të konsiderohen si dokument i përmbarueshëm.<sup>61</sup>

<sup>60</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008, Neni 14

<sup>61</sup> M Tutuli, 'Gazeta e zgjidhjes alternative të kontesteve në Kosovë' (2016) GZAKK 5, p. 45; Shiko në: [https://issuu.com/amchamkosovo/docs/journal\\_of\\_alternative\\_dispute\\_reso\\_f7c6caa079a86e](https://issuu.com/amchamkosovo/docs/journal_of_alternative_dispute_reso_f7c6caa079a86e)

Në të tre format e ndërmjetësimit, procedura mund të zgjasë deri në 90 ditë.<sup>62</sup> Përveç përfundimit të suksesshëm/të pasuksesshëm të procedurës, neni 14 i Ligjit për Ndërmjetësim njih edhe dy instanca tjera kur procedura mund të përfundojë: së pari, kur skadon afati 90-ditor i procedurës së ndërmjetësimit; dhe së dyti, kur ndërmjetësuesi/ja dhe palët bien dakord se nuk ka bazë të arsyeshme për të besuar se ndërmjetësimi mund të vazhdohet.

Ligji nuk rregullon procedurën e ndërmjetësimit për të mitur dhe arbitrazhin tregtar, dhe përcakton që këto duhet të rregullohen me ligje tjera të veçanta.<sup>63</sup>

Procedura e ndërmjetësimit gjithashtu ka kosto dhe ligji kryesisht i referohet atyre që lidhen me shërbimet e ndërmjetësuesit/es. Ligji i obligon palët të mbulojnë shpenzimet në mënyrë proporcionale, megjithëse kjo nuk vlen nëse ata/o kanë arritur një marrëveshje tjetër.<sup>64</sup> Në vitin 2011, Ministria e Drejtësisë lëshoi një udhëzim administrativ<sup>65</sup> që përcaktoi një honorar të kompensimit të normës bazë prej 25€ për një rast të ndërmjetësimit (megjithëse lejoi për shkallë më të lartë të kompensimit sipas marrëveshjes së palëve dhe ndërmjetësuesit/es). Në vitin 2012, Këshilli Gjyqësor i Kosovës nxori një udhëzim administrativ që i liroi palët nga përgjegjësia për të mbuluar shpenzimet bazë për shërbimet e ndërmjetësuesit/es në lëndët e gjykatës dhe mori shpenzimet në fjalë mbi vete.<sup>66</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës mori një pozicion të ngjashëm kur vendosi të mbulojë shpenzimet bazë të shërbimeve të ndërmjetësuesve për rastet e prokurorisë të referuara në ndërmjetësim. Të dyja, KGJK dhe KPK sollën këto masa me qëllim të zhvillimit dhe promovimit të ndërmjetësimit.

Ligji për Ndërmjetësim nuk vendos vetëm kornizën që e rregullon ndërmjetësimin, por gjithashtu krijon një Komision të Ndërmjetësimit; përgjegjës për zhvillimin e procedurës dhe të ndërmjetësuesve në Kosovë, mbikëqyrjen e shërbimeve të ndërmjetësimit, mirëmbajtjen e rrjetit dhe regjistrin të ndërmjetësuesve dhe promovimin e ndërmjetësimit.<sup>67</sup> Komisioni do të ketë pesë anëtarë - Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Odën e Avokatëve të Kosovës dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.<sup>68</sup> Filloi zyrtarisht funksionimin në 2009,<sup>69</sup> dhe i miraton vendimet me shumicë të thjeshtë votash.<sup>70</sup>

---

<sup>62</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008, Neni 13

<sup>63</sup> Po aty, Neni 28

<sup>64</sup> Po aty, Neni 16

<sup>65</sup> Ministria e Drejtësisë, Udhëzim Administrativ Nr. 05/2011 për honorarin e ndërmjetësuesve 2011

<sup>66</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzim Administrativ Nr. 02/2012 mbi pagesën e ndërmjetësuesve për lëndët e gjykatës të referuara në ndërmjetësim 2012

<sup>67</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008, Nenet 17 dhe 19

<sup>68</sup> Po aty, Neni 18

<sup>69</sup> Intervistë me Lindita Ademi, Kryetare e (ish) Komisionit për Ndërmjetësim 2013 - 2017

<sup>70</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008, Neni 21

Në vitin 2011, Komisioni për Ndërmjetësim i regjistroi dhe Ministria e Drejtësisë i licenoi ndërmjetësuesit e parë të vendit.<sup>71</sup> Ligji Nr. 03/L-057 definon "ndërmjetësuesin/en" si palë e tretë neutrale, që është i/e autorizuar të ndërmjetësojë në mes të dy palëve. Ata/o duhet të synojnë zgjidhjen e kontesteve dhe duhet të veprojnë në përputhje me parimet e ndërmjetësimit.<sup>72</sup> Ligji rendit një numër kriteresh për ndërmjetësues. Ata/o duhet të kalojnë trajnimin për ndërmjetësim; të posedojnë një diplomë universitare; të kenë kualitete të larta morale; të mos kenë qenë të dënuar për vepër penale me dashje për të cilën parashihet dënimi mbi gjashtë muaj burgim; të kenë ndërmjetësuar nën mbikëqyrjen e një ndërmjetësuesi/e të paktën në gjashtë sesione; të jenë të regjistruar në regjistrin e ndërmjetësuesve.<sup>73</sup>

Ligji përcakton që Komisioni udhëheq trajnimet për ndërmjetësues, i lëshon certifikatat për ndërmjetësues dhe mban të drejtën të propozojë<sup>74</sup> pezullimin ose revokimin e licencave të ndërmjetësuesve të dhëna nga Ministria e Drejtësisë.<sup>75</sup>

Edhe pse neni 1 i Ligjit për Ndërmjetësim thotë se rregullon ndër të tjera të drejtat e ndërmjetësuesve, duhet të theksohet se ligji nuk parasheh dispozita relevante lidhur më këtë. Në fakt, vetëm neni 25 i referohet të drejtave të ndërmjetësuesve dhe madje edhe atëherë vetëm brenda kontekstit specifik të procedurës së ndërmjetësimit (thotë se të drejtat e ndërmjetësuesit/es definohen në marrëveshje me palët para fillimit të procedurës). Me fjalë të tjetra, nuk prezanton dispozita specifike që në përgjithësi i kushtohen të drejtave ose interesave të ndërmjetësuesve.

Neni në vijim i Ligjit (26) njeh ndërmjetësuesit e huaj dhe shërbimin e tyre në Kosovë. Sidoqoftë, ky nen aplikohet vetëm për raste individuale, kërkon reciprocitet dhe i nënshtrohet pëlqimit të Ministrisë së Drejtësisë.

Në fund të vitit 2010 dhe në 2011, Komisioni i Ndërmjetësimit dhe Ministria e Drejtësisë nxorën shtatë akte (një udhëzim administrativ,<sup>76</sup> një kod dhe pesë rregullore<sup>77</sup>) që adresuan honorarin e ndërmjetësuesve si dhe trajnimin, certifikimin, licencimin, regjistrimin, mirësjelljen, dhe përgjegjësitë dhe procedurën disiplinore të ndërmjetësuesve.

#### Kodi i mirësjelljes së ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës (2010)

<sup>71</sup> Komisioni për Ndërmjetësim, Regjistri i ndërmjetësuesve të Kosovës 2017

<sup>72</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008, Neni 2

<sup>73</sup> Po aty, Neni 22

<sup>74</sup> Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>75</sup> Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim 2008, Nenet 22-23

<sup>76</sup> Ministria e Drejtësisë, Udhëzim Administrativ Nr. 05/2011 për honorarin e ndërmjetësuesve 2011

<sup>77</sup> Të disponueshme në: <http://www.kontrata.net/?cid=2,95>

- 🚩 Rregullore për përzgjedhjen e pjesëmarrësve për trajnim në ndërmjetësim (2011)
- 🚩 Rregullore për regjistrimin e ndërmjetësuesve (2011)
- 🚩 Rregullore mbi përgjegjësinë dhe procedurën disiplinore të ndërmjetësuesve (2011)
- 🚩 Rregullore për trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësuesve (2011)
- 🚩 Rregullore për licencimin e ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës (2011)

Ligji i parë i Ndërmjetësitimit në Kosovë mbështetet në modele rajonale (të Shqipërisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës) dhe europiane (të Austrisë dhe Gjermanisë).<sup>78</sup> Komisioni i Ndërmjetësitimit ishte aktiv deri në vitin 2018.

### Ndërmjetësimi sipas Kodit të Drejtësisë Nr. 03/L-193 për të Mitur<sup>79</sup>

Procedura e ndërmjetësitimit për të mitur rregullohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur (Nr. 03/L-193) dhe me kapitujt III dhe XV të Kodit. Fillimi i procedurës së ndërmjetësitimit për të mitur ngjan në përgjithësi me procedurën standarde; ajo fillon vetëm kur palët (kryerësi/ja i/e mitur dhe pala e dëmtuar) pajtohen dhe zgjat deri në 90 ditë.<sup>80</sup> Më ndryshe nga aplikimet tjera, në procedurën e ndërmjetësitimit për të mitur, është prokurori apo kolegji për të mitur që janë përgjegjës për emërimin e ndërmjetësuesit/es.<sup>81</sup> Kodi gjithashtu përcakton se honorari për ndërmjetësuesin/en për procedurën e ndërmjetësitimit për të mitur mbulohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (kur rasti me të mitur referohet nga gjykata) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (kur rasti me të mitur referohet nga prokuroria).<sup>82</sup>

### Ndërmjetësimi "në praktikë"

Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim u miratua në vitin 2008, por infrastruktura dhe masat mbështetëse, të nevojshme për të filluar implementimin e tij u vendosën vetëm rreth 3 vite më vonë. Bekim Ismaili, ndërmjetësues dhe Menaxher i Projektit në CSSP observon: "Progresi i ndërmjetësitimit ndërmjet viteve 2008 dhe 2011 ishte i ngadaltë sepse korniza përcjellëse ligjore për ndërmjetësimin po zhvillohej dhe akterët relevant ende nuk kishin kuptim të gjërë dhe njohuri të nivelit të lartë të ligjit dhe të procedurës së ndërmjetësitimit."<sup>83</sup>

<sup>78</sup> Intervistë me Shukrije Gashi, Drejtoreshë Ekzekutive/Partners Kosova - Qendra për Menaxhimin e Konflikteve; B Bahtiri & I Qerimi, 'Ndërmjetësimi si mënyrë e zgjidhjes alternative të kontesteve në Kosovë' (2014) NMZAKK 291, f. 298; Shiko në: [https://www.researchgate.net/publication/306527279\\_Mediation\\_as\\_a\\_Way\\_of\\_Alternative\\_Resolution\\_of\\_Disputes\\_in\\_Kosovo](https://www.researchgate.net/publication/306527279_Mediation_as_a_Way_of_Alternative_Resolution_of_Disputes_in_Kosovo)

<sup>79</sup> Kodi No. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur 2010; Kodi rregullon procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve, procedurën gjyqësore dhe procedurën e ndërmjetësitimit për të mitur.

<sup>80</sup> Kodi No. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur 2010, Nenet 14 dhe 81

<sup>81</sup> Po aty, Neni 81

<sup>82</sup> Po aty, Neni 81

<sup>83</sup> Intervistë me Bekim Ismaili, Ndërmjetësues/Menaxher i Projektit, CSSP

Komisioni për Ndërmjetësim filloi punën në vitin 2009<sup>84</sup> dhe CSSP, Bashkimi Europian,<sup>85</sup> UNDP, USAID dhe Partners Kosova ofruan mbështetje në kapacitete të ndryshme, si në zhvillimit e akteve nënligjore të ndërmjetësimit,<sup>86</sup> hartimin e një manuali profesional të ndërmjetësimit,<sup>87</sup> organizimin e konferencave dhe aktiviteteve që informuan palët e interesuara (vendimmarrësit, komunitetin juridik dhe publikun e gjerë) mbi ndërmjetësimin,<sup>88</sup> përgatitjen e materialit për certifikimin e ndërmjetësuesve<sup>89</sup> dhe ofrimin e trajnimeve profesionale të ndërmjetësimit.

Korniza për përgatitjen e ndërmjetësuesve dhe implementimin e ligjit u bë në fund të 2010 dhe në 2011 kur Komisioni për Ndërmjetësim dhe Ministria e Drejtësisë nxorën aktet nënligjore që adresonin aspektet e ndërmjetësimit në lidhje me ndërmjetësuesit (shiko f. 15-16).

Këto akte udhëzuan përzgjedhjen, trajnimin, certifikimin, licencimin dhe regjistrimin e ndërmjetësuesve të parë të vendit dhe krijuan një mjedis të përshtatshëm për aktivitete të ndërmjetësimit. Në vitin 2011, Komisioni për Ndërmjetësim dhe Ministria e Drejtësisë, në implementim të ligjit dhe të akteve të lartpërmendura regjistruan dhe licencuan 87 ndërmjetësues.<sup>90</sup> CSSP, EU, UNDP, USAID dhe Partners Kosova ofruan mbështetje (financiare dhe me ekspertizë) dhe ndihmuan në drejtimin dhe implementimin e trajnimeve dhe proceseve shoqëruese për ndërmjetësuesit.<sup>91</sup> Ndërmjetësuesit e parë të licencuar të vendit (kryesisht të përkatësisë shqiptare të Kosovës) vijnë nga rajonet: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Pejë dhe Prishtinë.<sup>92</sup> Ministria e Drejtësisë nuk kishte burime të mjaftueshme për të krijuar mekanizma ose struktura gjithëpërfshirëse për të organizuar dhe administruar "referimin e rasteve" dhe procedurën e ndërmjetësimit, prandaj arriti marrëveshje me CSSP-në,<sup>93</sup> UNDP-në dhe USAID-in që mundësonin hapjen e Qendrave të Ndërmjetësimit në disa rajone të vendit.<sup>94</sup>

Këto Qendra janë mekanizma ose struktura që ofrojnë ndërmjetësim, organizojnë dhe administrojnë referimin/pranimin e rasteve nga gjykatat dhe prokuroritë dhe vendosin proceset shoqëruese në vend; ato mundësojnë ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës dhe

---

<sup>84</sup> Intervistë me Lindita Ademi, Kryetare e (ish) Komisionit për Ndërmjetësim 2013 - 2017

<sup>85</sup> Projekti i Binjakezimit i BE-se

<sup>86</sup> Intervistë me Virgjina Dumnica, Eksperte e ndërmjetësimit/Këshilltare për Sundim të Ligjit, UNDP

<sup>87</sup> Intervistë me Bekim Ismaili, Ndërmjetësues/Menaxher i Projektit, CSSP

<sup>88</sup> Intervistë me Shukrije Gashi, Drejtoreshë Ekzekutive/Partners Kosova - Qendra për Menaxhimin e Konfliktëve

<sup>89</sup> Po aty

<sup>90</sup> Komisioni për Ndërmjetësim, Regjistri i ndërmjetësuesve të Kosovës 2017

<sup>91</sup> Konkluzion nga intervista me Lindita Ademi, Kryetare e (ish) Komisionit për Ndërmjetësim 2013 - 2017 dhe Bekim Ismaili, Ndërmjetësues/Menaxher i Projektit, CSSP

<sup>92</sup> Intervistë me Lindita Ademi, Kryetare e (ish) Komisionit për Ndërmjetësim 2013 - 2017

<sup>93</sup> Intervistë me Bekim Ismaili, Ndërmjetësues/Menaxher i Projektit, CSSP

<sup>94</sup> Intervistë me Virgjina Dumnica, Eksperte e ndërmjetësimit/Këshilltare për Sundim të Ligjit, UNDP

mbledhin ndërmjetësuesit nën ombrella rajonale. Institucionet nuk kishin kapacitete të mjaftueshme për të mbajtur parimet e ligjit në praktikë dhe për t'a funksionalizuar atë. Qendrat, me mbështetjen e akterëve të jashtëm (donatorëve) dhe në bashkëpunim me Komisionin për Ndërmjetësim,<sup>95</sup> u angazhuan për përmbushjen në praktikë të ligjit dhe mungesave të kapaciteteve të institucioneve. Qendrat e para u hapën në 2011 dhe 2012 në Ferizaj, Gjakovë,<sup>96</sup> Pejë, Gjiilan,<sup>97</sup> dhe u pasuan nga Prishtina në vitin 2013.<sup>98</sup>

Në vitin 2013, Ministria e Drejtësisë licencoi një grup prej 12 ndërmjetësuesve të përkatësisë etnike shqiptare dhe boshnjake të Kosovës, kryesisht nga rajoni i Prishtinës dhe ai i Mitrovicës, të përgatitur nga CSSP.<sup>99</sup> CSSP gjithashtu hapi një Qendër të Ndërmjetësimit në rajonin e Mitrovicës në mars të vitit 2013. Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë ka dy degë (një në veri dhe një në jug) të qytetit të ndarë të Mitrovicës dhe staf multietnik. Pastaj në vitin 2016, Qendra shkrihet apo bashkohet në një të vetme dhe zona multietnike e njohur si Lagjja e Boshnjakëve në Mitrovicë bëhet baza e operimeve të saj. Puna e Qendrës nuk është e lidhur ngushtë vetëm me ndërmjetësimin sipas ligjit, por gjithashtu ka pasur dhe ka elemente të ndërtimit të paqes, që tregohet edhe në angazhimin e vazhdueshëm të pasardhësit të saj ADRC-së që punon për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës,<sup>100</sup> të cilët (kryesisht) jetojnë në anët e kundërta të lumit Ibër që përshkon në zemër të Mitrovicës. Qendra fundit u hap në Prizren në vitin 2014,<sup>101</sup> dhe në të njëjtin vit 71 ndërmjetësues u shtuan në regjistrin e ndërmjetësve të vendit.<sup>102</sup>

Kështu në vitin 2014, shtatë rajonet kryesore të Kosovës kishin infrastrukturën dhe kapacitetet e nevojshme për të ofruar ndërmjetësimin e lidhur me gjykatën, me prokurorinë dhe ndërmjetësim privat/jashtë gjykatës. Akterë të jashtëm apo partnerët bashkëpunuan me Komisionin për Ndërmjetësim për të hapur Qendrat, të cilat u mbikëqyrën nga Komisioni.<sup>103</sup> Secila Qendër kishte strategjinë e saj të brendshme, e cila u zhvillua nga akterët themelues apo donatorët në përputhje me legjislacionin e ndërmjetësimit dhe në bashkëpunim me Komisionin. Përderisa secila Qendër është unike (dhe kjo i atribuohet faktorëve që lidhen me mënyrën e

---

<sup>95</sup> Po aty

<sup>96</sup> Të hapura nga Partners Kosova dhe UNDP. Të mbështetura nga UNDP; Intervistë me Shukrije Gashi, Drejtoreshë Ekzekutive/Partners Kosova - Qendra për Menaxhimin e Konfliktëve

<sup>97</sup> Të mbështetura nga USAID; Intervistë me Hasie Abdullahu, Eksperte e ndërmjetësimit/Projekt i USAID

<sup>98</sup> Mbështetur nga UNDP; Ministria e Drejtësisë, 'Qendra e Ndërmjetësimit hapet në Prishtinë' (md.rks-gov.net 2013) <<https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=2,15,1093>> qasur më 25 maj 2020

<sup>99</sup> Komisioni për Ndërmjetësim, Regjistri i ndërmjetësuesve të Kosovës 2017; Intervistë me Bekim Ismaili, Ndërmjetësues/Menaxher i Projektit, CSSP

<sup>100</sup> Përmes ndërmjetësimit siç njihet me ligj, ndërmjetësimit në komunitet dhe projekteve të fokusuar në pajtim dhe zhvillim.

<sup>101</sup> Mbështetur nga USAID; Intervistë me Hasie Abdullahu, Eksperte e ndërmjetësimit/Projekt i USAID

<sup>102</sup> Komisioni për Ndërmjetësim, Regjistri i ndërmjetësuesve të Kosovës 2017

<sup>103</sup> Intervistë me Virgjina Dumnica, Eksperte e ndërmjetësimit/Këshilltare për Sundim të Ligjit, UNDP

financimit dhe politikat e akterëve/donatorëve, zhvillimet lokale dhe kontekstin rajonal), përfshirja dhe angazhimi i Komisionit është unifikues dhe përshkon e lidh secilën prej tyre.

Grupi i fundit i ndërmjetësuesve (kryesisht të përkatësisë serbe të Kosovës) nga rajoni i Mitrovicës<sup>104</sup> u trajnua nga CSSP dhe Qendra e Ndërmjetësimit Mitrovicë në vitin 2016 dhe pranuan licencat e tyre një vit më vonë nga Ministria e Drejtësisë. Procesi i licencimit u shoqërua me vështirësi pasi diplomat e tyre fillimisht nuk u njohën nga institucionet e Kosovës. Një udhëzim administrativ i lëshuar nga Qeveria e Kosovës më vonë e largoi këtë pengesë, dhe CSSP dhe Qendra e Ndërmjetësimit Mitrovicë mbështetën ndërmjetësuesit e grupit në fjalë në procesin e verifikimit të diplomave të tyre.

Ka pasur dhe vazhdon të ketë shqetësime më të gjëra rreth pjesëmarrjes së komuniteteve jo-shumicë të Kosovës në ndërmjetësim - për shembull, ndërmjetësuesit serbë të Kosovës nga rajoni i Mitrovicës janë pjesëtarët e vetëm të këtij komuniteti që punojnë në këtë fushë.<sup>105</sup> Kjo tregon se ishte dhe vazhdon të jetë e vështirë për pjesëtarët e këtij komuniteti që jetojnë në jug të rajonit të Mitrovicës për t'i qasur dhe përdorur shërbimet e ndërmjetësuesve të komunitetit të tyre dhe që poashtu kanë gjuhën e njëjtë amtare (atë serbe).

Në vitin 2017 kishte 189 ndërmjetësues të regjistruar,<sup>106</sup> trajnimi i të cilëve ishte i mbështetur kryesisht nga akterë vendorë dhe ndërkombëtarë (CSSP dhe Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë, EU, UNDP, USAID, Partners Kosova) në bashkëpunim me Komisionin për Ndërmjetësim. Ata/o u certifikuan nga Komisioni dhe u licencuan nga Ministria e Drejtësisë; detajet dhe informatat e tyre u shtuan më pas në regjistrin e ndërmjetësuesve të Kosovës,<sup>107</sup> të shpërndarë me Qendrat për Ndërmjetësim dhe institucionet relevante, siç janë gjykatat dhe prokuroritë. Megjithatë, regjistri ofron vetëm informacione bazike dhe nuk elaboron mbi përkatësinë etnike, vendbanimin ose specializimin e ndërmjetësuesve.<sup>108</sup>

Ndërmjetësuesit e licencuar dhe të regjistruar jo gjithmonë praktikojnë ndërmjetësimin, dhe kjo i atribuohet një numri faktorësh duke përfshirë vdekjen, tërheqjen nga ndërmjetësimi, ose rolet apo funksionet që nuk i lejojnë ata/o të ushtrojnë atë, etj. Sipas regjistrit të ndërmjetësuesve të Kosovës të mirëmbajtur nga Komisioni për Ndërmjetësim, asnjë

---

<sup>104</sup> Kryesisht nga komunat më veriore të Kosovës.

<sup>105</sup> Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADRC – Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë); Intervistë me Lindita Ademi, Kryetare e (ish) Komisionit për Ndërmjetësim 2013 – 2017; Intervistë me Dusan Radaković, Ndërmjetësues/OJQ Qendra për Avokim të Kulturës Demokratike (ACDC)

<sup>106</sup> Komisioni për Ndërmjetësim, Regjistri i ndërmjetësuesve të Kosovës 2017

<sup>107</sup> Ministria e Drejtësisë, Rregullore për regjistrimin e ndërmjetësuesve (2011)

<sup>108</sup> Lidhur me ndërmjetësimin.

ndërmjetësues i/e ri/e nuk është licensuar pas vitit 2017.<sup>109</sup> Megjithëse, ligji u lejon ndërmjetësuesve të ofrojnë shërbimet e tyre në tërë Kosovën, pjesa më e madhe punojnë në vendbanimin e tyre ose afër Qendrës "rajonale". Një numër i konsiderueshëm i tyre praktikojnë ndërmjetësimin si angazhim sekondar.<sup>110</sup> Ndërmjetësuesit që morën pjesë takimet e punës dhe intervistat e ADRC-së<sup>111</sup> deklaruan se u bënë ndërmjetësues për shkak të dëshirës për të promovuar pajtimin dhe zhvillimin e komunitetit dhe për të ndihmuar palët në mosmarrëveshje për të mbyllur ato; por ata/o poashtu deklaruan se e kanë zgjedhur ndërmjetësimin për të përfituar e përvetësuar shkathtësi që do mund të ju ndihmonin në tregun e punës. Disa përmendën gjithashtu se në përzgjedhjen dhe praktikimin e ndërmjetësimit ishin ndikuar nga familjarët e tyre, që janë marrë me ndërmjetësimin tradicional.<sup>112</sup>

Në qershor 2018, Këshilli Prokurorial i Kosovës morri një vendim (Nr. 268/2018) përmes së cilit ndaloi pagesat apo rimbursimin prej 25€ për shërbimet e ndërmjetësuesve në rastet e prokurorisë. Si rezultat, barra për honorarin e ndërmjetësuesve kaloi mbi palët. Kjo krijoi një situatë të re dhe të paqartë se si të vazhdohet me procedurën e pagesës/rimbursimit. Rajone dhe ndërmjetësues të ndryshëm vendosën praktika dhe modalitete të ndryshme në përgjigje ndaj këtij zhvillimi (përfshirë hapjen e bizneseve individuale<sup>113</sup> ose numrave fiskal),<sup>114</sup> me qëllim të përafrimit dhe respektimit të legjislacionit të Kosovës në lidhje me tatimin mbi të ardhurat.<sup>115</sup> Pas qershorit 2018, nuk kishte ndonjë rregullim apo praktikë të harmonizuar që mbi menyrën apo procedurën e pagesës/rimbursimit së honorarit të ndërmjetësuesve për ndërmjetësimin e lidhur me prokurorinë/rastet e prokurorisë. Kjo gjithashtu nënkuptoi se ngarkesa, shpenzime dhe përgjegjësi shtesë u vunë mbi supet e ndërmjetësuesve, të cilët edhe kështu kishin dhe kanë një honorar standard dhe modest për shërbimet e tyre.

Shtatë sfida kryesore ballafaquan zhvillimin dhe implementimin e ndërmjetësimit në periudhën 2008-18. Edhe pse disa u evidentuan në një fazë të hershme dhe pastaj u tejkaluan, të tjerat qëndruan dhe ndikuan në mekanizmin përgjatë fazës së dytë. Ato vijojnë:

- 🚩 Ndërmjetësimi i institucionalizuar paraqet një zhvillim të ri dhe nuk njihet gjerësisht, prandaj nuk ka një kuptim plotë dhe të arrirë mbi të dhe të gjitha aspektet e tij; kjo është sfida në procesin e hartimit dhe nxerrjes së legjislacionit sekondar.<sup>116</sup> Për më tepër,

<sup>109</sup> Komisioni për Ndërmjetësim, Regjistri i ndërmjetësuesve të Kosovës 2017

<sup>110</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>111</sup> Të realizuara për këtë publikim.

<sup>112</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>113</sup> Sugjeruar nga Sekretariati i Komisionit për Ndërmjetësim 2017.

<sup>114</sup> Ose tjetër.

<sup>115</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>116</sup> Intervistë me Bekim Ismaili, Ndërmjetësues/Menaxher i Projektit, CSSP; Intervistë me Lindita Ademi, Kryetare e (ish) Komisionit për Ndërmjetësim 2013 – 2017



ndërmjetësimi nuk është prioritet për akterët institucionalë. Kjo nënkupton më pak ose aspak mjete të alokuara për implementimin e tij dhe Komisionin e Ndërmjetësimit; kjo gjë limiton zhvillimin e mekanizmit dhe aftësinë e Komisionit për të punuar në mënyrë proporcionale në të gjithë vendin.<sup>117</sup>

- ✚ Institucionet e Kosovës nuk investojnë sa duhet në ndërmjetësim dhe kjo do të thotë se mekanizmi varet nga akterët e jashtëm/donatorët, komuniteti më i gjerë i cilëve nuk është shumë i interesuar për të investuar në këtë fushë.<sup>118</sup>
- ✚ Kapacitetet e pamjaftueshme krijojnë varësi nga jashtë, e kjo shfaqet në veçanti në rekrutimin dhe trainimin e ndërmjetësuesve<sup>119</sup> dhe ofrimin e ndërmjetësimit.
- ✚ Fakti që gjyqtarët dhe prokurorët në disa rajone në përgjithësi nuk janë të njohur apo të familjarizuar me ndërmjetësimin tregon se ata/o nuk referojnë raste aq sa duhet në Qendrat për Ndërmjetësim. Si rezultat, as gjykatat dhe as prokuroritë nuk përfitojnë nga zvogëlimi i rasteve dhe nga më pak raste që hyjnë në procedurë gjyqësore; poashtu personat fizikë dhe juridik nuk përfitojnë nga mundësia për t'u qasur në drejtësi në kohë të shkurtë dhe shpenzime të ulëta (ndër të tjera).
- ✚ Qytetarët dhe palët në mosmarrëveshje nuk janë poashtu të njohur me ndërmjetësimin, dhe kjo mund të nënkuptojë që ata/o janë më pak të gatshëm të shfrytëzojnë atë.
- ✚ Përmbarimi i marrëveshjeve të ndërmjetësimit privat/jashtë gjykatës është i paqartë, dhe kjo dekurajon përdorimin e ndërmjetësimit.
- ✚ Numri i ulët i ndërmjetësimeve do të thotë që ndërmjetësuesve u mungojnë mundësitë për të zhvilluar aftësitë dhe përvojën e tyre dhe kjo, përveç honorarit të ulët për shërbime, ndikon negativisht dhe në cilësinë e ndërmjetësimit.

Megjithëse disa nga sfidat ishin të pranishme që nga krijimi dhe funksionalizimi i ndërmjetësimit në vend, e intervistuar (Lindita Ademi) thotë se një numër i tyre u tejkalua përmes punës së përbashkët dhe angazhimit të vazhdueshëm të partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Akterët e jashtëm/partnerët që mbështesin ndërmjetësimin kontribuan në draftimin e akteve nënligjore dhe gjithashtu u angazhuan drejtëpërdrejtë në rekrutimin, trajnimin, certifikimin dhe licencimin e ndërmjetësuesve. Pjesëmarrja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës në Komisionin e Ndërmjetësimit gjithashtu bëri të mundur që ata/o të inkurajojnë gjyqtarët dhe prokurorët të përdorin ndërmjetësimin dhe të referojnë raste.<sup>120</sup>

---

<sup>117</sup> Intervistë me Lindita Ademi, Kryetare e (ish) Komisionit për Ndërmjetësim 2013 – 2017

<sup>118</sup> Intervistë me Dusan Radaković, Ndërmjetësues/OJQ Qendra për Avokim të Kulturës Demokratike (ACDC)

<sup>119</sup> Intervistë me Lindita Ademi, Kryetare e (ish) Komisionit për Ndërmjetësim 2013 – 2017

<sup>120</sup> Po aty

Aktivitetet dhe trajnime të fokusuar në ndërmjetësim ndihmuan gjyqtarët dhe prokurorët të kenë një mirëkuptim të shtuar dhe më të arrirë të ndërmjetësit. Konferenca, takime dhe tryeza të rrumbullakëta angazhuan palët e interesuara (krerët e gjykatave/prokurorive, gjyqtarët, prokurorët, policinë dhe përfaqësuesit e komunitetit juridik) dhe u komunikuan atyre në mënyrë proaktive përparësitë e ndërmjetësit. Kjo ndihmoi në krijimin e perceptimeve pozitive ndaj ndërmjetësit dhe komunikim e partneritet në mes të Qendrave për Ndërmjetësim dhe gjykatave/prokurorive. Gjithashtu ndikoi në rritjen e rasteve të referuara në Qendra. Ndërmjetësuesit krijuan përvojë, gjyqtarët dhe prokurorët fituan një vlerësim të shtuar për punën e tyre dhe të Qendrave për Ndërmjetësim – dhe – kjo kishte një reaktion zinxhiror me rritjen e një numri më të madh të referimit të rasteve të gjykatave dhe prokurorive në ndërmjetësim. Fushatat për ndërgjegjësim publik dhe aktivitetet promovuese stimuluan gjithashtu publikun e gjerë për të kuptuar dhe përdorur procedurën.<sup>121</sup>

Ndërmjetësimi në Kosovë tregoi indikacione të qarta të progresit dhe zhvillimit të vazhdueshëm, mirëpo ende kishte një numër të sfidave që mbetën si: mbështetja e pamjaftueshme institucionale, vartësia nga akterët e jashtëm/partnerët dhe paqëndrueshmëria që e shoqëron atë,<sup>122</sup> dilemat në lidhje me përmbarrimin e marrëveshjeve të ndërmjetësit privat/jashtë gjykatës, etj. Në vitin 2015, Ministria e Drejtësisë dhe akterët vendorë e ndërkombëtarë filluan adresimin e këtyre dhe sfidave tjera kur u angazhuan për të reformuar Ligjin për Ndërmjetësim të Kosovës.

---

<sup>121</sup> Intervistat me përfaqësuesit e (ish) Komisionit për Ndërmjetësim, CSSP-së, UNDP-së, Partners Kosova.

<sup>122</sup> Në vitin 2016, tre Qendra të mbështetura nga USAID zvogëluan funksionet e tyre dhe në rajonet përkatëse për një periudhë të caktuar ndërmjetësimi ishte i disponueshëm vetëm në një masë të kufizuar (Intervistë me Hasie Abdullahu, Eksperte e ndërmjetësit/Projekt i USAID; CSSP/ADRC-MCM 'Praktika e ndërmjetësit në sektorin e biznesit në veri të Kosovës' (2016) PNSBVK 1, f. 5; Shiko në: [www.mediation-mitrovica.org/sq/publications/](http://www.mediation-mitrovica.org/sq/publications/). Në mesin e vitit 2017, Këshilli Gjyqësor i Kosovës i'u përgjigj kësaj situate dhe Ligjit të ri për Ndërmjetësim në ardhje, duke i ftuar gjykatat që të caktojnë zyrtarë të gjykatës që të angazhohen me procesin e "referimit të lëndëve" dhe ndërmjetësimin e lidhur me gjykatën. Në fund të vitit 2017, Këshilli Prokurorial i Kosovës ftoi prokurorët të ndërmarrin hapa të ngjashëm. Kështu, ndërmjetësimi më pas u bë përgjegjësi e një zyrtari/e të gjykatës/prokurorisë. Kjo u aplikua kryesisht në rajonet pa qendra aktive të ndërmjetësit. Mund të argumentohet se ndërmjetësimi privat/jashtë gjykatës u prek veçanërisht nga këto zhvillime. Në vitin 2018, u mbyllën tre qendra të tjera (të ndërmjetësit) të mbështetura nga UNDP (Intervistë me Virgjina Dumnica, Eksperte e ndërmjetësit/Këshilltare për Sundim të Ligjit, UNDP). Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve - Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë është e vetmja që vazhdoj të funksionojë.

## Përmbledhje e Statistikave të Ndërmjetësimit: 2008 - 2018<sup>123</sup>

	Ferizaj 124	Gjakovë 125	Gjilan <sup>126</sup>	Mitrovic ë <sup>127</sup>	Pejë <sup>128</sup>	Prishtinë 129	Prizren 130	Totali
<b>TË REFERUARA NË NDËRMJETËSIM</b>	903	499	1100	1194	745	1945	1065	7451
<b>TË ZGJIDHURA NË NDËRMJETËSIM</b>	721	374	930	1106	543	1899	827	6400
<b>TË PAZGJIDHURA NË NDËRMJETËSIM</b>	68	92	128	88	157	46	37	616

### Ndërmjetësimi bashkëkohor në Kosovë: Faza III

Më 23 korrik 2018, Parlamenti i Kosovës miratoi një Ligj të ri të Ndërmjetësimit (Nr. 06/L-009) i cili hyri në fuqi më pak se dy muaj më vonë. Nga kjo pikë e tutje, ndërmjetësimi qeveriset në përputhje me:

- 🚩 Ligjin për Ndërmjetësim (Nr. 06/L-009)<sup>131</sup>
- 🚩 Kodin e Procedurës Penale (No. 04/L-123)<sup>132</sup>
- 🚩 Kodit të Drejtësisë për të Mitur (Nr. 06/L-006)<sup>133</sup>
- 🚩 Një numër aktesh nënligjore të nxjerra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë.

Sfidat dhe problematikat të lidhura me Ligjin e parë të vendit për Ndërmjetësim dhe implementimin e tij vunë në pah nevojën për ndryshime të mëtejshme. Bashkimi Europian (BE)

<sup>123</sup> Statistikat për të gjitha rajonet përveç Mitrovicës janë marrë nga Ministria e Drejtësisë. Ministria nuk posedon statistikave të vitit 2016 për tre rajone. Statistikat e rajonit të Mitrovicës janë të ADRC - Qendrës për Ndërmjetësim Mitrovicë.

<sup>124</sup> 2012 - 2018 (përveç 2016)

<sup>125</sup> 2012 - 2018 (përveç 2016)

<sup>126</sup> 2012 - 2018

<sup>127</sup> 2013 - 2018

<sup>128</sup> 2012 - 2018

<sup>129</sup> 2012/13 - 2018 (përveç 2016)

<sup>130</sup> 2014 - 2018

<sup>131</sup> Ligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim 2018

<sup>132</sup> Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale 2012, Neni 232

<sup>133</sup> Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur 2018, Nenet 9-11

gjithashtu kërkoi/kërkon forcimin e ndërmjetësimit në Kosovë dhe ndryshimi apo draftimi i një ligji të ri u pa si një nga mënyrat se si mund të arrihet kjo.<sup>134</sup> Ministria e Drejtësisë udhëheqi agjendën e reformës, e cila filloi të marrë formë dhe konsolidim në vitin 2015. Besim Kelmendi observon: “Komisioni për Ndërmjetësim, ndërmjetësuesit dhe partnerët e mbështetësit relevant informuan Ministrinë e Drejtësisë për problemet, për të cilat më pas filluan proceset për draftimin e një ligji të ri.<sup>135</sup> Procesi i draftimit u drejtua nga ministria dhe u mbështet nga akterët relevant.<sup>136</sup> Kishte mosmarrëveshje në mes të pjesëmarrësve të procesit, kryesisht në lidhje me aplikimin e ndërmjetësimit në rastet e dhunës në familje.<sup>137</sup> Një projektligj për ndërmjetësimin u aprovua në vitin 2017<sup>138</sup> dhe ligji, i cili u informua nga legjislacionet e ndërmjetësimit të Shqipërisë, Austrisë, Kroacisë dhe pak nga Sllovenia,<sup>139</sup> u miratua në korrik 2018.

## Ndërmjetësimi "në ligj"

Ligji i ri definon ndërmjetësimin si "procedurë jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës" dhe ky definicion qëndron në linjë me trupin e kaluar të legjislacionit.<sup>140</sup> Neni 1 përcakton se është në përputhje me Direktivën 2008/52/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit për aspekte të caktuara të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe komerciale. Ligji i ri ruan një numër të aspekteve dhe procedurave të paraardhësit dhe prezanton ndryshime të tjera. Ndryshimet kryesore që sjell janë:

### Ligji i ri zgjeron aplikimin e ndërmjetësimit në fushën penale.

Përderisa ligji i mëparshëm lejonte që ndërmjetësimi të aplikohet vetëm në rastet apo veprat kur dënimi ishte alternativ (me gjobë ose me burgim deri në 3 vite), ai tani zgjeron fushën edhe tek rastet apo veprat ku dënimi është kumulativ (dënimi me gjobë dhe burgim deri në 3 vite).<sup>141</sup> Kjo do të thotë që tani ndërmjetësimi mund të aplikohet në deri rreth 200 vepra

<sup>134</sup> Intervistë me Hasie Abdullahu, Eksperte e ndërmjetësimit/Projekt i USAID

<sup>135</sup> Intervistë me Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit/Ekspert i ndërmjetësimit

<sup>136</sup> Përfaqësuesit e CSSP dhe ADRC - Qendrës për Ndërmjetësim Mitrovicë, Zyrës së BE-së në Kosovë, Komisionit për Ndërmjetësim, Zyra Ligjore e Kryeministrit të Kosovës, ndërmjetësues, përfaqësues të UNDP-së, USAID, etj.; Intervistë me Hasie Abdullahu, Eksperte e ndërmjetësimit/Projekt i USAID

<sup>137</sup> Intervistat e realizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>138</sup> Qeveria e Kosovës, Projektligji për ndërmjetësim 2017; Shiko në: [https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/PROJEKTLIGJI\\_P%C3%8BR\\_ND%C3%8BRMJET%C3%8BSIM.pdf](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/PROJEKTLIGJI_P%C3%8BR_ND%C3%8BRMJET%C3%8BSIM.pdf)

<sup>139</sup> Intervistë me Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit/Ekspert i ndërmjetësimit

<sup>140</sup> Ligjvënësi e parafrazon pak më ndryshe definicionin e ndërmjetësimit, megjithatë në përmbajtje është po i njëjtë me definicionin e ligjit të kaluar.

<sup>141</sup> Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim 2018, Neni 2; Kjo vlen në rast se me ligj të veçantë nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës, prokurorisë apo e një organi tjetër kompetent.

penale,<sup>142</sup> megjithëse konsideratat ndaj interesit publik dhe kufizimet e tjera mund të zvogëlojnë këtë numër.<sup>143</sup>

Neni 2 i ligjit të ri përcakton gjithashtu se ndërmjetësimi nuk mund të zbatohet në rastet e dhunës në familje. Besim Kelmendi deklaroi se ai nuk ishte plotësisht dakord me këtë dhe thotë se të gjitha palët duhet të kenë të drejtë të barabartë për të kërkuar ndërmjetësim. Ai thekson se ligji i ri fillimisht e ofron të drejtën në ndërmjetësim dhe më pas e tërheq atë (në rastet e dhunës në familje). "Ndërmjetësimi duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë, pavarësisht nga statusi i tyre; nëse u ofrohet dhe është i qasshëm për ata/o që ngacmojnë dhe sulmojnë të tjerët, ose vjedhin prej tyre, atëherë edhe ata/o në marrëdhënie familjare që mund të kenë pasur njëherë një mosmarrëveshje të izoluar duhet të kenë të drejtën të aplikojnë ndërmjetësimin; në rast të përsëritjes, legjislacioni nuk u jep këtë të drejtë më gjithsesi."<sup>144</sup> Hasie Abdullahu argumenton të kundërtën. Ajo thotë se dhuna në familje është e përhapur në Kosovë dhe shton se nëse raste të tilla referohen në ndërmjetësim, të drejtat dhe interesat e viktimës mund të mos reflektohen në përfundim. Abdullahu observon: "Dhuna në familje është rast kompleks, dhe është e mundur që veprimet e pashprehura ose të pavërejtura që mund të jenë pjesë e sjellje apo modeli të dhunës të mund të anashkalohen; është e vështirë të zbatohet ndërmjetësimi dhe të ketë ekuilibër nëse njëra palë ndihet e frikësuar dhe heziton të shprehë qëndrimin e tij/saj duke marrë parasysh që palët kthehen në mjedisin e tyre të mëparshëm pas ndërmjetësimit".<sup>145</sup>

### Ligji i ri prezanton "Ndërmjetësimin e detyrueshëm".

Nenet 3 dhe 9 prezantojnë një formë të re të ndërmjetësimit të quajtur "Ndërmjetësimi i detyrueshëm", që obligon gjykatësin/en kompetent/e (për të referuar disa lloje të lëndëve në ndërmjetësim) dhe poashtu palët (për të provuar ndërmjetësimin). Ndërmjetësimi i detyrueshëm aplikohet në rastet apo lëndët që kanë të bëjnë me marrëdhëniet familjare (të tilla si: alimentacioni, kujdestaria, kontaktet, mbajtja e fëmijës dhe ndarja e pronës së përbashkët martesore) dhe në kontestet pronësore që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet nga të drejtat e servituteve, dhe kompensimi i pronës së shpronësuar.<sup>146</sup> Palët nuk janë të obliguara të hyjnë në procedurën e ndërmjetësimit apo të arrijnë marrëveshje; sidoqoftë, janë të detyruara

---

<sup>142</sup> M Krasniqi, 'Disa karakteristika të ndërmjetësimit në fushën penale në Republikën e Kosovës' (2019) DKNFPRK 190, f. 192; Shiko në: <https://www3.mruni.eu/ojs/international-comparative-jurisprudence/article/view/5219/4621>

<sup>143</sup> Një numër i faktorëve duhet të merren parasysh përpara se rasti/vepra penale të delegohet në ndërmjetësim, si: rrethanat e aktit, personaliteti i kryerësit/es (përfshirë historinë e mëparshme kriminale), shkalla e përgjegjësisë penale të kryesit/es dhe lloji dhe natyra e aktit; M Krasniqi, 'Disa karakteristika të ndërmjetësimit në fushën penale në Republikën e Kosovës' (2019) DKNFPRK 190, f. 193

<sup>144</sup> Intervistë me Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit/Ekspert i ndërmjetësimit

<sup>145</sup> Intervistë me Hasie Abdullahu, Eksperte e ndërmjetësimit/Projekt i USAID

<sup>146</sup> Ligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim 2018, Neni 9

të provojnë ndërmjetësimin dhe të takohen me ndërmjetësuesin brenda 30 ditëve nga kur gjyqtari/ja i ka informuar të provojnë apo të iniciojnë procedurën e ndërmjetësimit.<sup>147</sup> Nëse një marrëveshje për të hyrë në procedurën e ndërmjetësimit nuk arrihet një dëshmi në formë të shkruar se palët kanë e provuar ndërmjetësimin duhet t'i paraqitet gjykatës; palët pastaj mund të vazhdojnë në gjykatë ose të përdorin procedurën e arbitrazhit.<sup>148</sup>

### Ligji i ri i integron shërbimet e ndërmjetësimit brenda gjykatave dhe prokurorive.

Në përpjekje për të bërë ndërmjetësimin e qëndrueshëm, ligjvënësi e ka integruar atë brenda gjykatave dhe prokurorive. Neni 3 i ligjit të ri i referohet referentëve për ndërmjetësim<sup>149</sup> dhe hapësirës së punës.<sup>150</sup> Këto dispozita krijojnë një kornizë që vendos ndërmjetësimin brenda gjykatave dhe prokurorive dhe i detyron ato të ofrojnë ndërmjetësim (të lidhur me gjykatën/prokurorinë). Ky është një nga ndryshimet kryesore në ligj që bën të mundur vazhdimin e punës së Qendrave për Ndërmjetësim.

Publikuesi parashikon se mund të shfaqen një numër i sfidave në lidhje me këtë ndryshim. Më e rëndësishmja është se ndërmjetësimi përfshin koordinim me ndërmjetësuesit dhe palët, komunikim në lidhje me procesin e referimit të rasteve (me gjyqtarët/prokurorët), administrimin e rasteve, përcaktimin e sesioneve të ndërmjetësimit dhe mirëmbajtjen e kalendarëve për sesionet, raportim mujor dhe një sërë detyrash tjera administrative dhe logjistike, të cilat paraqesin një ngarkesë të madhe të punës që mund të kërcënojnë efikasitetin në kohë dhe cilësinë e ndërmjetësimit; si karakteristikat më të rëndësishme të mekanizmit. Pra, mund të jetë sfiduese që vetëm një referent të marrë përsipër realizimin e të gjitha përgjegjësiave dhe aktiviteteve të përmendura më lartë në lidhje me ndërmjetësimin. Ndërmjetësuesi Nebojsa Djokić shpreh se në rajone multietnike si Mitrovica, emërimi i një referenti/e të ndërmjetësimit mund të jetë e pamjaftueshme pasi ai/ajo do të jetë shqiptar ose serb. Kjo mund t'a bëjë të vështirë për të që të komunikojë me palët dhe ndërmjetësuesit nga komuniteti tjetër (ose anasjelltas) dhe gjithashtu të menaxhojë të gjithë procesin.<sup>151</sup>

Por, ligji i ri nuk e kufizon numrin e referentëve dhe kjo së paku krijon mundësinë që të mund të emërohet më shumë staf në përpjesëtim të drejtë me ngarkesën e punës dhe nevojat. Megjithatë, ndërmjetësimi nuk ka qenë prioritet për institucionet e vendit që nga fillimi dhe kështu nuk ka bazë të fortë për të supozuar se kjo do të ndodhë.

---

<sup>147</sup> Po aty, Neni 9

<sup>148</sup> Po aty, Neni 9

<sup>149</sup> Zyrtari/ja i/e gjykatës/prokurorisë që administron me rastet e referuara për ndërmjetësim dhe organizon procedurën e ndërmjetësimit të lidhur me gjykatë/prokurori.

<sup>150</sup> Zyrë apo ambient i përshtatshëm për zhvillimin e sesioneve dhe procedurës së ndërmjetësimit sipas parimeve të ndërmjetësimit, e cila do të jetë në kuadër të gjykatës/prokurorisë. Aktet relevante nënligjore lejojnë që procedura e ndërmjetësimit të kryhet dhe jashtë gjykatës/prokurorisë dhe në ambiente të përshtatshme.

<sup>151</sup> Intervistë me ndërmjetësuesin Nebojsa Djokić

### Ligji i ri sqaron përmbartimin e ndërmjetësimit privat/jashtë gjykatës.

Ligji i ri shënon përmirësim të qartë tek ndërmjetësimi privat/jashtë gjykatës. Përderisa paraardhësi i tij nuk ishte i qartë sa i përket pjesës së përmbartimit, ligji i ri investon fuqi të qarta përmbartuese në ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës. Neni 15 përcakton se marrëveshja e ndërmjetësimit privat/jashtë gjykatës që përmban klauzolën (vërtetimin) mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes ka fuqinë e dokumentit përmbartues në përputhje me ligjin përkatës për procedurën përmbartimore. Ky zhvillim pritet të rrisë përdorimin e ndërmjetësimit privat/jashtë gjykatës dhe gjithashtu ka potencial që të ul presionin mbi gjykatat dhe/apo prokuroritë.<sup>152</sup>

### Ligji i ri zgjat periudhën e procedurës së ndërmjetësimit.

Ligji i ri mban periudhën 90 – ditore dhe standarde të procedurës së ndërmjetësimit, por gjithashtu mundëson zgjatjen e procedurës edhe për 30 ditë shtesë, megjithëse kjo duhet t'i nënshtrohet akordit të palëve, ndërmjetësuesit/es dhe gjyqtarit/es apo prokurorit/es (në ndërmjetësimin e lidhur me gjykatën/prokurorinë). Në ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës, palët dhe ndërmjetësuesi/ja mund të nënshkruajnë një marrëveshje që lejon zgjatjen e procedurës së ndërmjetësimit. Megjithatë në të dy rastet (ndërmjetësimin e lidhur me gjykatën/prokurorinë dhe ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës) kjo nuk është e mundur nëse një vazhdim i tillë i afatit sjellë pasoja ligjore në humbjen e së drejtës ose fitimin e të drejtave për një palë me kalimin e kohës.<sup>153</sup>

### Ligji i ri lejon që teknologjia të aplikohet në ndërmjetësim.

Neni 11 i ligjit ofron mundësinë që teknologjia të përdoret për qëllime të ndërmjetësimit dhe kjo i ndihmon ata/o me kufizime të mundshme të lëvizjes ose që ndodhen jashtë vendit. Por, është e paqartë nëse kjo i referohet vetëm sesioneve të ndërmjetësimit apo tërë procedurës. Ekzistojnë edhe çështje praktike - procedura fillon vetëm pasi palët japin pëlqimin e tyre me gojë dhe me shkrim, dhe mund të jetë e vështirë që ata/o të bëjnë këtë, veçanërisht nëse gjenden jashtë vendit. Pjesëmarrësit në takimet e punës të organizuara për qëllimet e këtij publikimi dhe një prej të intervistuarve<sup>154</sup> pajtohen se kjo praktikë duhet të sqarohet më tej. Publikuesi observon se është shumë e rëndësishme që institucionet përkatëse të japin udhëzime të qarta në lidhje me këtë praktikë të re, pasi kjo do të ndihmojë për të shmangur diskrepancat në implementim dhe gjithashtu do të zvogëlojë gjasat që përfundimi apo rezultati final i procedurës të bëhet të fakt burim i mosmarrëveshjeve.

<sup>152</sup> B Kelmendi, 'Analizë Ligjore' (2018) AL 1, f. 1; Shiko në: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Raporte/Analiza%20ligjore%20p%C3%ABr%20nd%C3%ABr%20mjet%C3%ABsim.pdf>

<sup>153</sup> Ligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim 2018, Neni 16

<sup>154</sup> Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit/Ekspert i ndërmjetësimit

Më 30 prill 2020, Këshilli Gjyqësor i Kosovës nxori një vendim që lejon shfrytëzimin e një platforme dhe linku në internet për procedurën e ndërmjetësimit në lëndët e gjykatës. Shfrytëzimi apo jo i kësaj platforme dhe linku i është lënë në diskrecionin e palëve përkatëse dhe ndërmjetësuesve.<sup>155</sup> Kjo masë erdhi në përgjigje ndaj pandemisë COVID-19 dhe ka për qëllim të lehtësojë komunikimin dhe të mundësojë mbajtjen e sesioneve të ndërmjetësimit gjatë kësaj periudhe, por jo vetëm.<sup>156</sup>

#### Ligji i ri parashikon krijimin e një Ode të Ndërmjetësuesve.

Komsioni për Ndërmjetësim pushoi funksionimin para ardhjes së ligjit të ri,<sup>157</sup> dhe tani është Ministria e Drejtësisë përgjegjëse për politikën rreth ndërmjetësimit e gjithashtu dhe promovimin e tij.<sup>158</sup> Departamenti për Profesionet e Lira i Ministrisë mbikëqyr ligjshmërinë e punës së ndërmjetësuesve<sup>159</sup> dhe mbledh statistikat e ndërmjetësimit.

Ligji i ri gjithashtu përcakton dispozita për krijimin e një Ode të Ndërmjetësuesve si person juridik i pavarur jofitimprurës,<sup>160</sup> që kërkon të sjellë ndërmjetësuesit nën një ombrellë, të mbrojë interesat e tyre, të asistojë ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës, dhe të promovojë zhvillimin e përgjithshëm të ndërmjetësuesve dhe ndërmjetësimit. Neni 21 përcakton se Oda formohet dhe funksionon në bazë të statutit të miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i Ndërmjetësuesve dhe të aprovuar nga Ministria e Drejtësisë. Oda është themeluar më 2 nëntor 2019,<sup>161</sup> dhe organet e saj kryesore janë: *Kuvendi i Përgjithshëm i Ndërmjetësuesve i përbërë nga ndërmjetësuesit e licencuar të Kosovës*;<sup>162</sup> *Bordi i Odës i përbërë nga shtatë ndërmjetësues që përfaqësojnë secilin nga shtatë rajonet e Kosovës*; *Kryetari i Odës*.

Në njërën nga intervistat, ndërmjetësuesi Nebojsa Djokić deklaroi se procesi përmes të cilit u krijua Oda ishte shumë i politizuar ("Votimi i organeve të Odës dhe përfaqësimi në këto organe u zgjodh ngjashëm dhe sikur në bazë të anëtarësisë politike"). Ai gjithashtu shprehu skepticizëm në lidhje me kapacitetet e Odës për të mbështetur zhvillimin e procedurës së ndërmjetësimit.<sup>163</sup>

---

<sup>155</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Vendimi Nr. 82/2020 (2020)

<sup>156</sup> Intervistë me Hasie Abdullahu, Eksperte e ndërmjetësimit/Projekt i USAID

<sup>157</sup> Intervistë me Bekim Ismaili, Ndërmjetësues/Menaxher i Projektit, CSSP

<sup>158</sup> Ligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim 2018, Neni 20

<sup>159</sup> Divizioni për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së Profesioneve të Lira (që përfshin ndërmjetësuesit); Ministria e Drejtësisë, 'Departamenti për Profesionet e Lira' (md.rks-gov.net) <<https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=2,27>> qasur më 25 maj 2020

<sup>160</sup> Ligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim 2018, Neni 21

<sup>161</sup> koha.net, 'Themelohet Oda e Ndërmjetësuesve, synohet zgjidhje më e lehtë e kontesteve mes qytetarëve' (koha.net 2019) <<https://www.koha.net/arberi/192010/themelohet-oda-e-ndermjetesuesve-synohet-zgjidhje-me-e-lehte-e-kontesteve-mes-qytetareve/>> qasur më 20 maj 2020

<sup>162</sup> Statuti i Odës së Ndërmjetësuesve përcakton se të gjithë ndërmjetësuesit e Kosovës që kanë licencë duhet të jenë anëtarë të Odës.

<sup>163</sup> Intervistë me Nebojsa Djokić, Ndërmjetësues



Oda pritet të mbahet kryesisht nga kontributet e obligueshme të anëtarëve të saj. Jo të gjithë ndërmjetësuesit janë aktivë, dhe për këtë arsye është e diskutueshme nëse Oda do të arrijë të jetë e qëndrueshme nga anëtarësia e saj marrë parasysh këtu edhe nevojat e kërkesat për infrastrukturë në përgjithësi, dhe kapacitete njerëzore për të organizuar punën dhe administratën e Odës.<sup>164</sup>

Neni 21 i ligjit përcakton se Oda dhe aktet e saj duhet të aprovohen nga Ministria e Drejtësisë, por kjo ende nuk ka ndodhur.<sup>165</sup>

Përgatitja e ndërmjetësuesve të rinj është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë që është autoriteti kompetent i ngarkuar me trajnimin, certifikimin<sup>166</sup> dhe licencimin e ndërmjetësuesve. Kriteret për t'u bërë ndërmjetësues janë të ngjashme me legjislacionin e mëparshëm.

#### Ligji i ri obligon nxjerrjen e akteve nënligjore.

Ligji i ri i Ndërmjetësimit obligon draftimin dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për të rregulluar në detaje aspekte të tij dhe për të udhëzuar implementimin e mëtutjeshëm.

Neni 8 obligon Këshillin Gjyqësor të Kosovës të nxjerrë një akt nënligjor që definojnë referimin e lëndëve të gjykatave në ndërmjetësim dhe ndërmjetësimin e lidhur me gjykatën. Më 8 maj 2019, KGJK-ja lëshoi rregulloren përkatëse dhe forma e marrëveshjes së ndërmjetësimit është e përfshirë.<sup>167</sup> Rregullorja është në funksion të ligjit të ri dhe përmban dispozita adekuate për referimin e lëndëve të gjykatave në ndërmjetësimin dhe administrimin e ndërmjetësimit të lidhur me gjykatën. Sidoqoftë, rishkruan në masë të konsiderueshme dispozitat e vetë ligjit të ri, e kjo nuk duhet të jetë norma, pasi aktet nënligjore kanë për qëllim të ofrojnë detaje të nevojshme që sqarojnë implementimin e ligjit dhe nuk janë në natyrë të synuara që të përsërisin dispozitat e ligjit.<sup>168</sup>

I njëjti nen obligon Këshillin Prokurorial të Kosovës të përgatisë dhe miratojë një akt nënligjor që ka të bëjë me referimin e rasteve të prokurorisë në ndërmjetësim dhe ndërmjetësimin e lidhur me prokurorinë, dhe kjo rregullore është lëshuar më 3 qershor 2019.<sup>169</sup> Në mënyrë të ngjashme me rregulloren e KGJK-së, ajo ka dispozita dhe detaje relevante në lidhje me referimin e rasteve të prokurorisë në ndërmjetësim dhe administrimin e

<sup>164</sup> Intervistë me Hasie Abdullahu, Eksperte e ndërmjetësimit/Projekt i USAID

<sup>165</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>166</sup> Ligji i kaluar i ngarkonte në mënyrë primare këtë përgjegjësi (për trajnim dhe certifikim) Komisionit për Ndërmjetësim.

<sup>167</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Rregullore Nr.04/2019 për procedurën e ndërmjetësimit të lëndëve të gjykatave 2019

<sup>168</sup> G Shala/Instituti i Kosovës për Drejtësi, 'Progresi dhe regresi i Këshillave' (2019) PRK 2, f. 12

<sup>169</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës, Rregullore Nr. 04/2019 për procedurën e ndërmjetësimit të rasteve nga prokuroria 2019

ndërmjetësimin të lidhur me prokurorinë; poashtu ngjashëm si me rregulloren e KGJK-së, përsërit një numër të elementeve që mund të gjenden në legjislacionin primar (Ligjin për Ndërmjetësimin dhe Kodin e Procedurës Penale).<sup>170</sup> Kapitulli III i kësaj rregulloreje gjithashtu i referohet procedurës së ndërmjetësimin për të mitur.

Përderisa aktet nënligjore paraprake të të njëjtit qëllim përcaktuan procedurën dhe referimin nga gjykatat/prokuroritë në Qendrat e Ndërmjetësimin, rregulloret aktuale definojnë procedurën dhe referimin të rasteve nga gjykatat/prokuroritë brenda të dy këtyre institucioneve.

Neni 8 i ligjit të ri gjithashtu vendos detyra mbi Ministrinë e Drejtësisë për të nxjerrë akt nënligjor që rregullon ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës. Kjo akt nuk është nxjerrë ende. Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë deklaruan se ky akt është në pritje të nënshkrimit nga ministri/ja dhe se ky është limiti i njohurive të tyre për momentin mbi këtë çështje.<sup>171</sup> Pothuajse 20 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, një akt i rëndësisë së lartë ende mungon. Implementimi i ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës mbetet jo shume i qartë - megjithëse ligji i ri përcakton në mënyrë të kuptueshme mekanizmat dhe procedurën e ndërmjetësimin të lidhur me gjykatën/prokurorinë, nuk arrin të bëjë të njëjtën, veçanërisht, për procedurën, administrimin, dhe raportimin e ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës.<sup>172</sup>

Akti nënligjor mbi tarifën për shërbimet e ndërmjetësuesve gjendet në situatë të njëjtë. Ministria e Drejtësisë raporton se, akti nënligjor i lartpërmendur ende nuk është nënshkruar ministri/ja përgjegjës/e. Ligji i ri parasheh se tarifa e re për shërbimet e ndërmjetësuesve do të jetë ekuivalente apo e përafërt me tarifën e shërbimeve që ofrohen në kuadër të profesioneve të tjera të lira.<sup>173</sup> Në mungesë të aktit nënligjor përkatës, tarifa bazë prej 25€ – e direktivës së mëparshme administrative vazhdon të jetë aktive.

Për sa kohë që legjislacioni sekondar mbetet i mangët dhe i pa-plotësuar, ndërmjetësimi nuk do të arrijë potencialin e tij të plotë dhe përfitimet e tij të gjëra do të mbesin të pa-shfrytëzuara.

---

<sup>170</sup> G Shala/Instituti i Kosovës për Drejtësi, 'Progresi dhe regresi i Keshillave' (2019) PRK 2, f. 33

<sup>171</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>172</sup> Duhet rikujtuar se, në periudhën 2008-2018, nuk kishte akte nënligjore që rregullonin ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës dhe as nuk ishin të referua nga ligji.

<sup>173</sup> Ligji Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim 2018, Neni 19

Ministria e Drejtësisë ende nuk ka nxjerrë aktet nënligjore të përmendura më lart, mirëpo ajo ka arritur të lëshojë ato të përshkruara në nenin 27 të ligjit të ri.<sup>174</sup> Këto akte nënligjore (gjithsej 5) u nënshkruan më 27 nëntor 2019, rreth 7 muaj pas periudhës së përcaktuar me ligjin e ri.<sup>175</sup> Ky konfirmim i vonuar dhe mungesa e akteve të tjera nënligjore janë shqetësuese dhe duket se janë dëshmi të një angazhimi dhe/apo prioritizimi të pamjaftueshëm institucional të ndërmjetësimit. Edhe pse reformat u justifikuan dhe janë ndërmarrë mbi bazën se do të forcojnë ndërmjetësimin, kjo nuk do të ndodhë në mënyrë të duhur dhe të plotë nëse institucionet nuk respektojnë kushtet thelbësore për këtë, siç është kompletimi i infrastrukturës nënligjore. Mungesa e stabilitetit politik dhe ndryshimet në qeveri ishin dhe do të përmenden në nga akterët përgjegjës si shkaktarë dhe faktorë justifikues, mirëpo duhet të theksohet se ishte Ministria e Drejtësisë që udhëhoqi reformën në ndërmjetësim. Në të njëjtën masë, duhet të rikujtohet gjithashtu se draftimi i akteve nënligjore nuk ishte transparent dhe/apo gjithëpërfshirës. Përvojat e ADRC-së e konfirmojnë këtë, pasi përpjekjet e saj për t'u angazhuar dhe për të kontribuar në procesin e draftimit të akteve nënligjore nuk shënuan reciprocitet.

### Ndërmjetësimi sipas të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (Nr. 06/L-006)<sup>176</sup>

Më 14 shtator 2018, u miratua Kodi i ri i Drejtësisë për të Mitur (Nr. 06/L-006). Kapitulli II i referohet ndërmjetësimit dhe nenet 9, 10 dhe 11 rregullojnë procedurën për të mitur dhe gjithashtu selektimin e ndërmjetësuesit/es (ndër të tjera).<sup>177</sup> Neni 9 përcakton qartë se Prokurori i Shtetit për të Mitur mund të propozojë ndërmjetësimin nëse ai/ajo e konsideron të përshtatshme dhe pasi të ketë vlerësuar një numër të faktorëve.<sup>178</sup>

Një nga ndryshimet kryesore në krahasim me Kodin e mëparshëm<sup>179</sup> e që lidhet me ndërmjetësimin ka të bëjë me zgjedhjen e ndërmjetësuesit/es që tani i është lënë palëve.<sup>180</sup> Nëse ata/o nuk arrijnë akord për këtë, ndërmjetësuesi/ja cakohet nga Prokurori i Shtetit për të Mitur.<sup>181</sup> Përderisa Kodi i mëparshëm dhe Ligji aktual për Ndërmjetësimin vendosnin/vendosin

<sup>174</sup> Këto akte nënligjore kanë të bëjnë me 1. Trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësuesve; 2. Licencimin e ndërmjetësuesve; 3. Mbikëqyrjen, përgjegjësinë dhe procedurën disiplinore të ndërmjetësuesve; 4. Regjistrin e ndërmjetësuesve; 5. Kodin e mirësjelljes së ndërmjetësuesve.

<sup>175</sup> 'Gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Drejtësisë nxjerr aktet nënligjore...'

<sup>176</sup> Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur 2018; Kodi rregullon veprimin ndaj të miturit si kryes i veprës penale, fëmijët e përfshirë dhe të miturit si pjesëmarrës në procedurë, organet të cilat zbatojnë procedurën penale dhe ekzekutimin e masave dhe dënimeve ndaj kryesit të mitur të veprës penale, si dhe mbrojtjen e personave të mitur dhe fëmijëve të cilët janë viktimë dhe të dëmtuar nga vepra penale.

<sup>177</sup> Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur 2018

<sup>178</sup> Si natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e kthimit të raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe re-integrimit të tij/saj në shoqëri.

<sup>179</sup> Kodi Nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur 2010

<sup>180</sup> Palës së mitur dhe palës së dëmtuar.

<sup>181</sup> Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur 2018, Neni 9

një periudhë standarde prej 90-ditëve për procedurën e ndërmjetësimit, Kodi i ri përcakton që procedura e ndërmjetësimit për të mitur nuk duhet të zgjasë më gjatë se 30 ditë.<sup>182</sup>

Ata/o që kanë për qëllim të ndërmjetësojnë raste me të mitur duhet të plotësojnë kritere shtesë. Rrjedhimisht duhet që: të kenë përvojë pune prej të paktën 5 vite me të mitur; të mos kenë të shqiptuar ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës; të mos kenë dënim për vepër penale e cila e bënë të papërshtatshëm për të ushtruar profesionin; dhe të posedojnë certifikatë të lëshuar organi kompetent për ndërmjetësim për trajnimin e kryer për ndërmjetësues për të mitur.<sup>183</sup>

## Ndërmjetësimi "në praktikë"

Nga shtatori 2018, ndërmjetësimi në Kosovë implementohet në bazë të Ligjit të ri Nr. 06/L-009 të Ndërmjetësimit. Pjesëmarrësit në aktivitetet e realizuara për qëllimet e këtij publikimi dhe hulumtimi vënë në dritë një sërë sfidash dhe vështirësish që e ndikojnë funksionimin dhe efikasitetin e ligjit të ri.

**Ndërmjetësimi i detyrueshëm** ende nuk implementohet në nivelet e duhura nga gjyqtarët e Gjykatave Themelore të Kosovës. Besim Kelmendi vëren se ky është një nga aspektet në të cilin implementimi i ligjit nuk qëndron si duhet. Kjo formë e ndërmjetësimit u prezantua për të rritur aplikimin e procedurës në lëndë të caktuara,<sup>184</sup> me pritjen se një gjë e tillë do të zvogëlonte numrin e lëndëve të tilla në gjykata. Megjithatë, gjykatësit respektiv ende nuk kanë filluar të respektojnë plotësisht dispozitat e ligjit të ri që obligojnë referimin e lëndëve në fjalë. Në bazë të përvojës së ADRC-së, mund të thuhet në përgjithësi se lëndët që bien nën ndërmjetësimin e detyrueshëm i nënshtrohen më pak procedurës së ndërmjetësimit sesa p.sh rastet e natyrës penale. Kjo mund t'i atribuohet faktit se gjyqtarët e fushës civile referojnë tradicionalisht më pak raste në ndërmjetësim dhe janë më hezitues për të angazhuar procedurën. Pjesëmarrësit në takimet e punës të organizuara për qëllimet e këtij publikimi interpretuan referimin përgjithësisht më të ulët të rasteve civile në ndërmjetësim me kompleksitetet dhe implikimet që këto kanë, dhe thanë se në raste të caktuara civile është e vështirë të përmyllet procedura e ndërmjetësimit brenda periudhës së saj kohore. Duke përmendur këtë si një arsye për aplikimin më të vogël të ndërmjetësimit në lëndët civile dhe për

---

<sup>182</sup> Po aty, Neni 9

<sup>183</sup> B. Kelmendi, 'Analizë Ligjore' (2018) AL 1, f. 5-6; Shiko në: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Raporte/Analiza%20ligjore%20p%C3%ABr%20nd%C3%ABr%20mjet%C3%ABsim.pdf>

<sup>184</sup> Lëndët që kanë të bëjnë me marrëdhëniet familjare (të tilla si: alimentacioni, kujdestaria, kontaktet, mbajtja e fëmijës dhe ndarja e pronës së përbashkët martesore) dhe në kontestet pronësore që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet nga të drejtat e servituteve, dhe kompensimi i pronës së shpronësuar.

mos-respektimin e plotë të ndërmjetësimit të detyrueshëm, ata/o gjithashtu përmendën se faktorë të tjerë mund të luajnë rol.<sup>185</sup>

Intervistat dhe takimet e organizuara për qëllimet e këtij publikimi, dhe poashtu hulumtimi i realizuar vënë në pah se **integrimi i ndërmjetësimit brenda gjykatave dhe prokurorive ende nuk është arritur në mënyrë adekuate dhe se nuk ka radhitje të plotë me legjislacionin e ri**. Ky i fundit implikon qartë:

1. Emërimin e referentëve të ndërmjetësimit në gjykata/prokurori për pranimin e rasteve të referuara, administrimin e procesit të referimit dhe procedurat përcjellëse të ndërmjetësimit të lidhur me gjykatën/prokurorinë.
1. Krijimin dhe ofrimin e hapësirave të punës brenda gjykatave/prokurorive për ndërmjetësimin; punën e referentit/es të ndërmjetësimit dhe administratën, dhe zhvillimin e sesioneve dhe procedurave të ndërmjetësimit të lidhur me gjykatën/prokurorinë.

Por, Gjykatat dhe Prokuroritë Themelore të vendit akoma nuk i kanë akomoduar këto kërkesa në praktikë në mënyrë adekuate dhe të plotë.

Shtatë Gjykatat Themelore të Kosovës aktualisht kanë referenta të ndërmjetësimit në emër. Kështu, me përjashtim të Gjykatës Themelore të Prishtinës,<sup>186</sup> referentët e ndërmjetësimit në Gjykatat tjera Themelore janë në të vërtetë zyrtarë të cilëve u është dhënë ndërmjetësimi si detyrë dytësore në vartësi të roleve dhe detyrave të tyre primare.<sup>187</sup> Gjykata Themelore e Mitrovicës i ka caktuar detyra dhe përgjegjësi që lidhen me ndërmjetësimin dy zyrtarëve mbi përgjegjësitë e tyre primare.

Sa i përket hapësirave të punës, vetëm Gjykata Themelore e Prishtinës dhe Gjykata Themelore e Gjilanit i kanë këto në masë të mjaftueshme për ndërmjetësim (2 hapësira: 1 për referentin/en e ndërmjetësimit dhe aktivitetet administrative dhe 1 për realizimin e sesioneve dhe procedurave të ndërmjetësimit). Gjykatat Themelore të Ferizajt dhe Mitrovicës<sup>188</sup> kanë një hapësirë brenda të dedikuar për ndërmjetësim, ndërsa Gjykatat Themelore të Prizrenit, Pejës dhe Gjakovës nuk kanë hapësira të dedikuara vetëm për ndërmjetësim.<sup>189</sup>

---

<sup>185</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>186</sup> Gjykata Themelore e Prishtinës ka një referentë të ndërmjetësimit, detyra kryesore e së cilës është ndërmjetësimi.

<sup>187</sup> Bazuar në intervistimin dhe komunikimin me referentët e ndërmjetësimit të gjashtë Gjykatave Themelore.

<sup>188</sup> Gjykata Themelore Mitrovicë ka caktuar një zyre për ndërmjetësim në ndërtesën e gjykatës në Mitrovicën e veriut, që e bën procedurën më pak të qasshme për ata/o nga Mitrovica e jugut, Vushtrrisë, Skenderajt.

<sup>189</sup> Bazuar në intervistimin dhe komunikimin me referentët e ndërmjetësimit të gjashtë Gjykatave Themelore.

Hasie Abdullahu konfirmon se jo të gjitha Gjykatat Themelore kanë arritur të sigurojnë një infrastrukturë të mjaftueshme për integrimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit. Ajo thotë se një nga arsyet për këtë është në përgjithësi mungesa e hapësirave të lira brenda gjykatave që do të mund të ofroheshin për ndërmjetësim.<sup>190</sup>

Këshilli Gjyqësor i Kosovës akoma duhet të fillojë procesin dhe të alokojë mjete për pozitat e referentëve të ndërmjetësimit, përgjegjësia kryesore e të cilëve duhet të jetë administrimi i procesit të referimit të lëndëve për ndërmjetësim dhe i ndërmjetësimit të lidhur me gjykatën.<sup>191</sup> Edhe pse ky institucion është zotuar të punojë në këtë drejtim (të krijojë pozita dhe të emërojë referentë të ndërmjetësimit) ende nuk ka marrë masa konkrete në këtë drejtim.<sup>192</sup>

Situata në Prokuroritë Themelore është më pozitive pasi 5 prej tyre (në Mitrovicë, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Pejë) i kanë caktuar ndërmjetësimin një zyrtari/e i/e cili/e është i/e ngarkuar vetëm me këtë rol dhe përgjegjësi; Prokuroria Themelore e Prishtinës ka dy referentë të ndërmjetësimit për momentin.<sup>193</sup> Në anën tjetër, Prokuroria Themelore e Ferizajt ka një person që angazhon ndërmjetësimin bashkë me detyrat dhe rolet tjera e që i ka primare.<sup>194</sup>

Sa i përket hapësirave të punës, Prokuroritë Themelore të Prishtinës dhe Pejës janë të vetmet që kanë infrastrukturën e përshtashme për ndërmjetësim. Këto dy prokurori kanë krijuar dy hapësira të punës për ndërmjetësim – 1 për referentët e ndërmjetësimit (për procesin e referimit, administrimin e rasteve të referuara dhe aktivitetet përcjellëse) dhe 1 hapësirë pune për sesionet dhe procedurat e ndërmjetësimit. Prokuroritë tjera kanë vendosur ndërmjetësimin në një hapësirë pune që përdoret për të dyja: 1. për procesin e referimit, administrimin e rasteve të referuara dhe aktivitetet përcjellëse dhe 2. për sesionet dhe procedurat e ndërmjetësimit.<sup>195</sup>

Referentë të ndërmjetësimit duhet që ende të emërohen në mënyrë të fiksuar në një numër të Gjykatave dhe Prokurorive Themelore të vendit. Ndryshe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, buxheti i vitit 2020 i Këshillit Prokurorial të Kosovës përfshin shtatë referentë të ndërmjetësimit, të cilët janë gjithashtu të reflektuar në organogramin e tij institucional.<sup>196</sup>

---

<sup>190</sup> Intervistë me Hasie Abdullahu, Eksperte e ndërmjetësimit/Projekt i USAID

<sup>191</sup> Intervistë me Virgjina Dumnica, Eksperte e ndërmjetësimit/Këshilltare për Sundim të Ligjit, UNDP

<sup>192</sup> Po aty

<sup>193</sup> Bazuar në intervistimin dhe komunikimin me referentët e ndërmjetësimit të gjashtë Prokurorive Themelore.

<sup>194</sup> Po aty

<sup>195</sup> Po aty

<sup>196</sup> Intervistë me Virgjina Dumnica, Eksperte e ndërmjetësimit/Këshilltare për Sundim të Ligjit, UNDP

Nëse integrimi i ndërmjetësimit brenda gjykatave dhe prokurorive synon të jetë në nivelin e nevojshëm dhe të duhur, dhe nëse shërbime kualitative dhe efikase të ndërmjetësimit do të ofrohen nga gjykatat/prokuroritë, atëherë së paku 1 referent/e i/e ndërmjetësimit që ka këtë të fundit si detyrë dhe përgjegjësi kryesore duhet të emërohet, dhe 2 hapësira pune të veçanta (1 për referentin/en, procesin e referimit dhe administratën dhe 1 për sesionet dhe procedurat përcjellëse të ndërmjetësimit duhet të ofrohen). Këto janë parakushtet, por ende nuk janë përmbushur, siç u theksua më lart, në nivelin e kërkuar dhe të përshtatshëm nga një numër i gjykatave dhe prokurorive në të gjithë vendin. Virigjina Dumnica, një nga të intervistuarat, e shpjegon këtë situatë me atë se sipas saj sistemi gjyqësor nuk ishte i përgatitur sa duhet për të marrë përgjegjësitë e ndërmjetësimit.

Rregullorja relevante e Këshillit Gjyqësor të Kosovës që definojnë procesin e referimit të lëndëve në ndërmjetësim dhe ndërmjetësimin e lidhur me gjykatën gjithashtu përmend materiale informuese mbi ndërmjetësimin që t'u shpërndahen palëve që i qasen gjykatës.<sup>197</sup> Por, informatat e mbledhura nga hulumtimi, dhe intervistimi e komunikimi me referentët e caktuar për ndërmjetësim brenda gjykatave tregojnë se vetëm 2 Gjykata Themelore (në Mitrovicë dhe Ferizaj) posedojnë materiale të tilla ndërsa Gjykata Themelore e Prishtinës, ka por jo në sasi të mjaftueshme.

Besim Kelmendi pajtohet se në lidhje me ndërmjetësimin në gjykata dhe prokurori gjendja duhet të përmirësohet dhe se këto të fundit duhet të sigurohen që ndërmjetësimi të mos neglizhohet. Kelmendi observon se se një numër i gjykatave dhe prokurorive i kanë caktuar përgjegjësitë dhe aktivitetet e lidhura me ndërmjetësimin, bashkëpunëtorëve profesional, zyrtarëve ligjor apo pjesëtarëve tjerë të stafit dhe vëren se ka nevojë për përmirësime, ndërsa ai gjithashtu shton se është i angazhuar dhe avokon për një mjedis plotësisht të favorshëm për ndërmjetësimin që të krijohet.<sup>198</sup>

Disa nga pjesëmarrësit në takimet e punës të organizuara për këtë publikim e shohin pjesën e ligjit të ri që ka të bëjë me integrimin e ndërmjetësimit brenda gjykatave dhe prokurorive, si një hap pozitiv që do të zvogëlojë vartësinë ndaj donatorëve dhe fondeve të jashtme, dhe që poashtu do të rrisë numrin e rasteve të gjykatave/prokurorive të referuara në ndërmjetësim në nivel vendi. Megjithatë, ata/o gjithashtu përmendin se kjo mbase mund të ndikojë dhe negativisht në parimin e vullnetit të lirë, pasi palët mund të ndihen nën presion në gjykatë/prokurori, nga ambienti aty, prania e policies, etj. - mund të jetë ndryshe nga Qendrat e

---

<sup>197</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Rregullore Nr. 04/2019 për procedurën e ndërmjetësimit të lëndëve të gjykatave 2019, Neni 4

<sup>198</sup> Intervistë me Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit/Ekspert i ndërmjetësimit

Ndërmjetësimit dhe intimiduese, gjë që më pas mund të ndikojë vendimin e tyre dhe ata/o të ndihen të detyruar të marrin pjesë në procedurë, përkundër faktit që mund të mos jenë të bindur dhe plotësisht të vullnetshëm të bëjnë këtë.<sup>199</sup>

Një çështje tjetër janë **aktet nënligjore që mungojnë** e të cilat pritet të udhëzojnë dhe të përcaktojnë administrimin dhe procedurën e ndërmjetësimit privat/jashtë gjykatës dhe tarifën e ndërmjetësuesit/es. Të dyja duhet të nënshkruhen nga Ministri/ja i/e Ministrisë së Drejtësisë për të hyrë në fuqi. Kjo nuk ka ndodhur ende.

Mungesa e aktit nënligjor mbi ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës pengon zhvillimin e kësaj forme të mekanizmit dhe e bën më të vështirë për t'a qasur atë sepse, me përjashtim të rajonit të Mitrovicës me ADRC - Qendrën për Ndërmjetësim Mitrovicë aktive, nuk kishte dhe nuk ka struktura që mundësojnë qasje gjithëpërfshirëse në ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës dhe më pas raportimin e saj në Ministrinë e Drejtësisë. Mungesa e vazhdueshme e këtij akti nënligjor relevant kufizon disponueshmërinë dhe potencialet e procedurës së ndërmjetësimit në fjalë.

Në anën tjetër, mungesa e aktit nënligjor që rregullon tarifën e ndërmjetësuesve dhe procedurën e pagesës/rimbursimit është gjithashtu problematike sepse, pas vendimit të vitit 2018 të Këshillit Prokurorial të Kosovës (shiko f. 20: të ndërpres pagesat/rimbursimin për shërbimet e ndërmjetësuesve për rastet e prokurorisë), u vendosën praktika të ndryshme në pjesë të ndryshme të vendit. Si rezultat pas vendimit në fjalë të KPK-së nuk kishte më dhe nuk ka as për momentin një praktikë të harmonizuar për këtë. Disa nga "inovacionet" apo modalitetet që u punësuan ishin hapja e biznesit individual<sup>200</sup> ose e numrave fiskal në mënyrë që të respektohet legjislacioni i Kosovës mbi tatimin dhe të ardhurat. Në instanca të tjera, procedura të papërshtatshme të pagesave/rimbursimit mund të kenë ndodhur ose potencialisht të vazhdojnë të ndodhin. Praktikrat e krijuara pas vendimit të KPK-së, gjithashtu shtuan disa ngarkesa dhe shpenzime për ndërmjetësuesit. ADRC – Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë ka pranuar disa herë shqetësime dhe ankesa nga ana e ndërmjetësuesve të rajonit të Mitrovicës në lidhje me këto ngarkesa dhe shpenzime. Kështu, ndërmjetësuesit janë shprehur se shpenzimet minimale vjetore për të mbajtur biznes individual i kalojnë 600€, që do të thotë se ndërmjetësuesit duhet të angazhohen në së paku 24 raste në vit që të mund të përmbushin shpenzimet për biznes individual. Si rezultat, një numër prej tyre janë shkëputur nga praktikimi i ndërmjetësimit pasi nuk e kanë parë të përshtatshme për t'a vazhduar atë. Kjo i jep një

---

<sup>199</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>200</sup> Sugjeruar nga Sekretariati i Komisionit për Ndërmjetësim 2017.



urgjencë të shtuar imperativit për të lëshuar aktin nënligjor që do të rregullojë në mënyrë të njëjtë dhe adekuate këtë situatë. Në vitin 2019, Këshilli Gjyqësor i Kosovës gjithashtu mori një vendim të ngjashëm me atë të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe ndërpreu pagesat/rimbursimin për ndërmjetësues për shërbimet e tyre në lëndët e gjykatës.

**Oda e Ndërmjetësuesve është themeluar. Sidoqoftë, themelimi dhe aktet e saj duhet të aprohen nga Ministria e Drejtësisë dhe kjo ende nuk ka ndodhur.** Por ka pasur zhvillime pozitive pasi Ministria e Drejtësisë i ka ofruar mbështetje dhe zyre në Prishtinë, Odës së Ndërmjetësuesve. Dorëzimi i zyrës ishte caktuar fillimisht për mars të vitit 2020. Por pandemia COVID-19 e afektoi dorëzimin dhe e shtyu këtë.<sup>201</sup> Oda akoma nuk ka filluar funksionimin e saj të plotë dhe adekuat.<sup>202</sup> Në momentin që kjo do të ndodhë, pritet që Oda të angazhohet me ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës dhe të caktojë rregulla për hapësirat që do të shfrytëzohen për këtë procedurë.<sup>203</sup>

Ministria e Drejtësisë nuk ka përmbushur ende një pjesë të rëndësishme të përgjegjësisë që i janë ngarkuar me Ligjin e ri për Ndërmjetësim mirëpo, ka ndërmarrë disa hapa tjerë dhe konkret në përputhje me aktet nënligjore që ka nxjerrë.<sup>204</sup> Ministria ka filluar përditësimin e regjistrit të ndërmjetësuesve, që nënkupton rifreskimin e detajeve të ndërmjetësuesve dhe largimin e atyre që kanë ndërruar jetë, atyre që nuk dëshirojnë të praktikojnë ndërmjetësimin dhe atyre që kanë marrë apo janë punësuar në pozita që bien ndesh me rolin.<sup>205</sup> Përfaqësuesit e ministrisë që morën pjesë në njërin nga takimet e punës thanë se ky proces ka qenë, dhe vazhdon të jetë subjekt i sfidave, për faktin se një numër i ndërmjetësuesve kanë qenë të ngadaltë në përgjigje ose nuk janë përgjigjur deri më tani ndaj kërkesave të tyre për informacion. Ky proces është duke vazhduar dhe pritet që të përmbyllet në periudhën e ardhshme.<sup>206</sup> Regjistri do të përmbajë detajet e ndërmjetësuesve të licencuar të Kosovës: numrin e regjistrimit; emrin, mbiemrin, emrin e babait; numrin e telefonit dhe email-in; profesionin; natyrën e rasteve që ai/ajo ka ndërmjetësuar; datën dhe arsyjen potenciale të fshirjes nga regjistri.

---

<sup>201</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>202</sup> Po aty

<sup>203</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi; B Kelmendi, 'Analizë Ligjore' (2018) AL 1, f. 2; Shiko në: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Raporte/Analiza%20ligjore%20p%C3%ABr%20nd%C3%ABr%20mjet%C3%ABsim.pdf>

<sup>204</sup> Udhëzim Administrativ MD-Nr. 05/2019 për regjistrin e ndërmjetësuesve 2019

<sup>205</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>206</sup> Po aty

Ministria gjithashtu ka populluar faqen e saj të internetit dhe ka bërë të disponueshme një sasi të rëndësishme të informatave mbi ndërmjetësimin.<sup>207</sup>

Përderisa pjesa më lartë e këtij publikimi trajtoi disa nga sfidat kryesore në implementimin e ligjit të ri, pjesëmarrësit në takimet e punës për ndërmjetësim të organizuara për qëllimet e këtij publikimi gjithashtu i adresuan çështjet vijim:

- ✚ Domosdoshmërinë **për rritje të ndërgjegjësimit mbi ndërmjetësimin dhe promovimin** e tij të vazhdueshëm. Targetim i gjyqtarëve dhe prokurorëve për t'i inkurajuar ata/o që të referojnë më shumë raste në ndërmjetësim. Angazhimi me komunitetin juridik dhe avokatët në veçanti, vlerësohet si i rëndësishëm për t'i nxitur ata/o që t'i orientojnë klientët e tyre drejt ndërmjetësimit. Një rezultat i njëjtë do të mund të pritej dhe nga puna me publikun që mbetet në masë të konsiderueshme i panjohur me ndërmjetësimin. Pjesëmarrësit theksuan se ligji i ri kërkon ekspozim dhe familjarizim më të gjërë dhe intensiv nëse do të arrijë potencialin e tij të plotë.
- ✚ Kërkesat për ngritje të **kapaciteteve të ndërmjetësuesve** që do të përmirësonte njohuritë dhe të kuptuarit e tyre mbi legjislacionin e ri e që poashtu do të avanconte aftësitë e tyre të ndërmjetësimit.
- ✚ Nevojën për të organizuar **trajnime të dedikuara në përvetësimin e shkathtësive të ndërmjetësimit** në shërbim dhe dobi të referentëve të ndërmjetësimit të Gjykatave dhe Prokurorive Themelore.
- ✚ Rëndësinë e **monitorimit konsistent të implementimit praktik të ndërmjetësimit** në përputhje me parimin e konfidencialitetit, në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen problemet potenciale në mënyrë të vazhdueshme, të përkujdeset për cilësinë dhe të formulohen e bëhen përmirësime.

---

<sup>207</sup> Shiko në: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,41>

## Përmbledhje e Statistikave të Ndërmjetësimit: 2019<sup>208</sup>

	Ferizaj	Gjakovë	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	Prizren	Totali
<b>TË REFERUAR A NË NDËRMJETËSIM</b>	654	234	518	516	848	1142	1049	4961
<b>TË ZGJIDHURA NË NDËRMJETËSIM</b>	638	210	350	507	404	947	880	3936
<b>TË PAZGJIDHURA NË NDËRMJETËSIM</b>	9	8	128	9	444	131	59	788

Përhapja e COVID-19 ka limituar funksionimin dhe outputet e një numri të departamenteve dhe të sektorëve, dhe në disa raste ka rezultuar edhe me suspendimin e aktiviteteve të tyre. Si rezultat, statistikat e vitit 2020 të ndërmjetësimit ende nuk janë mbledhur dhe konfirmuar në mënyrë të plotë dhe të duhur. Por të gjeturat nga intervistimi dhe komunikimi i publikuesit me referentët e caktuar të ndërmjetësimit në gjashtë Gjykata Themelore dhe Prokurori Themelore<sup>209</sup> tregojnë se, në periudhën janar - mars ka pasur afërsisht 1392 raste të referuara nga Gjykatat Themelore dhe Prokuroritë Themelore në ndërmjetësim në nivelin vend prej të cilave rreth 828 janë ndërmjetësuar me sukses dhe diku 75 nuk kanë pasur përfundim të suksesshëm.<sup>210</sup> Numri i mbetur i rasteve është në proces.

## QENDRA PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË KONTESTEVE - QENDRA PËR NDËRMJETËSIM MITROVICË

Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë u hap në mars të vitit 2013 nga CSSP Qendra e Berlinit për Ndërmjetësim Integruar, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë në Prishtinë, Ambasadës së Zvicrës në Prishtinë dhe Zyrës Federale të Jashtme Gjermane. Në fund të vitit 2016, ajo u regjistrua si organizatë jo-qeveritare me emrin Qendra për Zgjidhjen

<sup>208</sup> Statistikat për të gjitha rajonet përveç Mitrovicës janë marrë nga Ministria e Drejtësisë. Statistikat e rajonit të Mitrovicës janë të ADRC - Qendrës për Ndërmjetësim Mitrovicë.

<sup>209</sup> Në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Pejë, Prishtinë, Prizren.

<sup>210</sup> Përfshirë statistikat e ADRC - Qendrës për Ndërmjetësim Mitrovicë dhe rajonit të Mitrovicës për periudhën janar - mars 2020.

Alternative të Kontesteve (ADRC) dhe që nga ajo kohë njihet si Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ADRC) - Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë (MCM).

Që nga themelimi i saj fillimisht nga CSSP dhe më pas si organizatë, ADRC - Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë ka mundur qasjen e lehtë, të shpejtë, dhe me kosto të ulët në drejtësi për qytetarët dhe personat juridik të rajonit të Mitrovicës. Puna e saj nuk ishte e lidhur vetëm me ndërmjetësimin sipas ligjit, po ka pasur dhe ka një komponent të rëndësishëm të ndërtimit të paqes që ka promovuar dhe promovon komunikimin ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës të rajonit të Mitrovicës, zgjidhjen e kontesteve dhe mosmarrëveshjeve brenda dhe ndëretnike, dhe, angazhimin e përbashkët.<sup>211</sup> ADRC - Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë ka pasur dhe vazhdon të ketë staf multietnik dhe operon në tre gjuhë (Shqip, Serbisht, dhe Anglisht).

Në periudhën 2013 - 2017, ADRC - Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë dha një kontribut të rëndësishëm dhe të jashtëzakonisht të vlefshëm për rajonin, të karakterizuar me qasje të kufizuar në drejtësi, sundim të zbehtë të ligjit dhe institucione të drejtësisë jo-plotësisht funksionale për shkak të ndarjeve dhe situatës më të gjërë të ndjeshme politike.<sup>212</sup>

Pas integritimit apo unifikimit të gjykatës dhe prokurorisë në Mitrovicë në fund të vitit 2017, ADRC - Qendra për Ndërmjetësim ndihmoi integrimin dhe punën e gjykatës dhe prokurorisë së integruar, dhe kontribuoi në veçanti në afrimin e qytetarëve serbë të Kosovës me ndërmjetësimin si mekanizëm për qasje në drejtësi. Dusan Radaković vlerëson ndërmjetësimin dhe këtë punë si shumë të rëndësishme sepse, në mjediset e prekura nga konflikti, qytetarët kanë tendencë t'i besojnë vetëm prokurorit/es apo gjykatësit/es nga komuniteti i tyre, dhe mund të mos jenë rehat apo të mos kenë besim kur rasti i tyre nuk trajtohet nga një pjesëtar/e i/e komunitetit të tyre. Duke bërë krahasimin me gjykata dhe prokurori, ai deklaroi se ky është një nga përparësitë kryesore të ndërmjetësimin dhe punës së ADRC - Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë, që u ofruan/ofrojnë qytetarëve mundësinë për të zgjedhur ndërmjetësues nga komuniteti i tyre, e kjo gjithashtu rrit besimin e përgjithshëm në sistemin ligjor dhe në drejtësi.<sup>213</sup> Për më tepër, ndërmjetësimi lejon mundësinë e përfshirjes së dy ndërmjetësuesve, gjë që nuk është rasti me gjykatën, dhe kjo është një përparësi e shtuar.<sup>214</sup>

---

<sup>211</sup> Që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë, rajoni i Mitrovicës është i ndarë në bazë të përkatësisë etnike. Shqiptarët e Kosovës banojnë kryesisht në Mitrovicën e jugut, ndërsa serbët e Kosovës banojnë kryesisht në Mitrovicën e veriut.

<sup>212</sup> Në periudhën 2013 - 2017, dy sisteme (të ndryshme) gjyqësore vepruan të ndara nga lumi Ibër. Sistemi në jug funksionoi sipas kornizës ligjore dhe sistemit të Kosovës ndërsa sistemi në veri mirëmbahej nga institucionet serbe.

<sup>213</sup> Intervistë me Dusan Radaković, Ndërmjetësues/OJQ Qendra për Avokim të Kulturës Demokratike (ACDC)

<sup>214</sup> Po aty

<sup>214</sup> Intervistë me Dusan Radaković, Ndërmjetësues/OJQ Qendra për Avokim të Kulturës Demokratike (ACDC)

<sup>214</sup> Po aty

Një rrjet rreth afër 60 ndërmjetësues të trajnuar dhe 50 të licencuar ka qenë dhe është i asociuar me ADRC – Qendrën për Ndërmjetësim Mitrovicë që nga themelimi i saj. Nga marsi 2013 deri në mars të vitit 2020, ADRC – Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë ka zgjidhur me sukses 1715 nga 1813 raste me më shumë se 4200 përfitues. E ka asistuar gjykatën dhe prokurorinë duke zvogëluar numrin e lëndëve të grumbulluara dhe parandaluar hyrjen e lëndëve të reja në procedura gjyqësore. Poashtu, ka ndërmjetësuar qasjen e shpejtë dhe me kosto të ulët të qytetarëve në drejtësi.

Në pajtim me gjykatën dhe prokurorinë në Mitrovicë, në fund të vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020, ADRC – Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë filloi procesin e bartjes apo transferimit të shërbimeve të ndërmjetësimit brenda në këto dy të fundit. Ky proces është në linjë me Ligjin (e ri) për Ndërmjetësim dhe vizionin e vetë ADRC - Qendrës për Ndërmjetësim Mitrovicë për qëndrueshmërinë e ndërmjetësimit.

Fillimisht ishte planifikuar që gjykata dhe prokuroria të fillonin me ndërmjetësimin në mars të vitit 2020. Por, pandemia COVID-19 e shtyu këtë plan për qershor të vitit 2020.

Në të ardhmen, ADRC – Qendra për Ndërmjetësim Mitrovicë do të vazhdojë të mbështesë në kapacitete të ndryshme zhvillimin e ndërmjetësimit në Kosovë dhe do të vendosë në theks të veçantë asistencën për gjykatën dhe prokurorinë në Mitrovicë. Për më tepër, do të vazhdojë të punojë për ndërmjetësimin në komunitet, proceset e pajtimit dhe zhvillimin e rajonit të Mitrovicës.

## REKOMANDIMET

- Ministria e Drejtësisë duhet pa vonesë të nxjerrë aktet nënligjore që rregullojnë ndërmjetësimin privat/jashtë gjykatës dhe tarifën e ndërmjetësuesve. Kompletimi i legjislacionit sekondar është i domosdoshëm pasi do të bëjë të mundur aplikimin dhe zhvillimin e ndërmjetësimit privat/jashtë gjykatës, përcaktimin e tarifave dhe praktikave përcjellëse, dhe do t'i ndihmojë ndërmjetësuesve për të organizuar, përmirësuar dhe për të përfituar nga shërbimet e tyre.
- Ministria e Drejtësisë, si pikë urgjente, duhet të aprovoj aktet e Odës së Ndërmjetësuesve. Ministria të vazhdojë të asistoj Odën. Akterët e jashtëm/partnerët që

punojnë në fushën e ndërmjetësimit të mbështesin funksionalizimin e plotë të Odës dhe forcimin e kapaciteteve të saj.

- ✚ Gjykatësit e Gjykatave Themelore të respektojnë dispozitat e Ligjit për Ndërmjetësim që kanë të bëjnë me ndërmjetësimin e detyrueshëm, i cili i detyron ata/o të referojnë lëndë të caktuara të natyrës civile në ndërmjetësim. Akterët e jashtëm/partnerët të ndihmojnë gjyqtarët që punojnë me lëndët që bien nën ndërmjetësimin detyrues të familjarizohen me ndërmjetësimin dhe legjislacionin e ri, dhe gjithashtu të përpiqen të lehtësojnë komunikimin dhe bashkëpunimin në mes të gjyqtarëve në fjalë dhe ndërmjetësuesve.<sup>215</sup>
- ✚ Kryetarët e Gjykatave Themelore dhe Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore duhet të inkurajojnë gjyqtarët dhe prokurorët që në përgjithësi të referojnë më shumë raste në ndërmjetësim.<sup>216</sup>
- ✚ Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykatat Themelore duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për të rekrutuar dhe/apo emëruar referentë të ndërmjetësimit (me përgjegjësi të vetme ndërmjetësimin).  
Numri i referentëve të ndërmjetësimit duhet të rritet si në gjykata ashtu edhe në prokurori në proporcion me ngarkesën e punës. Akterët e jashtëm/partnerët mund të ndihmojnë në këtë drejtim përmes programeve të ndryshme për praktikantë të vendosura në "pikat" e ndërmjetësimit brenda gjykatave dhe prokurorive.
- ✚ Gjykatat Themelore dhe Prokuroritë Themelore duhet të sigurojnë hapësira pune të përshtatshme dhe të mjaftueshme për ndërmjetësimin e lidhur me gjykatën/prokurorinë (aty ku mungojnë).
- ✚ Institucionet relevante<sup>217</sup> dhe akterët e jashtëm/partnerët duhet të punojnë së bashku për të rritur kapacitetet dhe shkathtësitë ndërmjetësuese të referentëve të ndërmjetësimit, dhe gjithashtu njohuritë dhe të kuptuarit e tyre të legjislacionit primar dhe sekondar të ndërmjetësimit. Palët e përmendura në fillim të këtij paragrafi gjithashtu të ndihmojnë në përgatitjen e programeve efikase të menaxhimit të "procesit të referimit e rasteve" dhe të infrastrukturave të përshtatshme administrative.

---

<sup>215</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>216</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.

<sup>217</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës

- ✚ Akterët e jashtëm/partnerët që punojnë në fushën e ndërmjetësimit duhet të përgatisin materiale informuese dhe promovuese për ndërmjetësimin, dhe pastaj t'i shpërndajnë ato në Gjykatat dhe Prokuroritë Themelore, në mënyrë që të mund të jenë të qasshme për ata/o që i qasen këtyre institucioneve dhe/ose palët e interesuara.
- ✚ Institucionet relevante<sup>218</sup> duhet të nxjerrin një akt ose udhëzim që sqaron aplikimin e teknologjisë në ndërmjetësim. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse kjo praktik e ligjit të ri nuk është mjaftueshëm e qartë (shiko f. 27).
- ✚ Deri në fund të vitit 2020, Ministria e Drejtësisë dhe akterët e jashtëm/partnerët duhet të angazhohen dhe të organizojnë trajnime për ngritjen e kapaciteteve për ndërmjetësuesit e licencuar të Kosovës. Përveç që parashihet me aktin nënligjor për trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësuesve,<sup>219</sup> kjo është gjithashtu një nevojë që pjesëmarrësit e takimeve të punës të këtij publikimi e kanë identifikuar. Trajnimi dhe përgatitja e ndërmjetësuesve nga komunitetet jo-shumicë duhet të jetë prioritet, pasi kjo do të sigurojë dhe të ngritë mundësinë e qasjes në ndërmjetësim për këto komunitete, dhe poashtu do t'i inkurajojë që të angazhojnë dhe përdorin procedurën.
- ✚ Ndërmjetësuesit duhet të jenë më proaktiv ndaj Ministrisë së Drejtësisë, në veçanti kur kjo e fundit kërkon informata dhe të dhëna me qëllim krijimin e një regjistri adekuat dhe përfaqësues të ndërmjetësuesve. Ministria gjithashtu duhet të marrë në konsideratë zgjerimin e përmbajtjes së regjistrit dhe të përfshijë informata mbi përkatësinë etnike dhe vendbanimin e ndërmjetësuesve.
- ✚ Ministria e Drejtësisë të vazhdojë të popullojë faqen e saj të internetit me përmbajtje mbi ndërmjetësimin dhe ftohet që gjithashtu të shtojë dhe ofrojë informacione mbi numrin e përfituesve dhe natyrën e rasteve të ndërmjetësuara, që për momentin mungojnë.
- ✚ Ata/o që ofrojnë ndërmjetësim duhet të raportojnë në baza të rregullta tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë dhe, kur bëjnë këtë, duhet të plotësojnë standardet e larta të raportimit.

<sup>218</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe/apo Ministria e Drejtësisë

<sup>219</sup> Udhëzim Administrativ Moj-Nr. 06/2019 për trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësuesve 2019

- ✚ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Ministria e Drejtësisë dhe akterët e jashtëm/partnerët që mbështesin ndërmjetësimin duhet, në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim, të punojnë për të promovuar ndërmjetësimin dhe për të vënë në pah përparësitë e tij. Kjo mund të bëhet përmes mediave sociale dhe tradicionale, konferencave të ndryshme, diskutimeve, tryezave të rrumbullakëta, aksioneve në rrugë, ligjeratave në universitet, etj.<sup>220</sup>
- ✚ Shërbimet e ndërmjetësimit të gjykatave, prokurorive, dhe ndërmjetësuesve duhet të monitorohen në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe raportime të shpeshta të dokumentojnë zhvillimet e fundit, të garantojnë kualitet, të identifikojnë sfidat dhe të sugjerojnë përmirësime të mundshme.

---

<sup>220</sup> Takimet e punës mbi ndërmjetësimin të organizuara për qëllimet e këtij publikimi.



Projekt i financuar nga UNMIK